

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE / TERMAVE TË REFERENCËS

SPECIFIKIME TEKNIKE

ME OBJEKT

**REGJISTRIMI FILLESTAR
I PASURIVE TË PALUAJTSHME
NË 106 ZONA KADASTRALE**

**(Kryerja e procesit të Regjistrimit Fillestar për 106 Zona kadastrale pa RF,
kryesisht në Qarqet Veriore në Republikën e Shqipërisë)**

SHKURTIME

ALBSCAD	Baza Shtetërore e të dhënave Kadastrale
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës, që përfshin DPASHK dhe DVASHK
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
DAMT	Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës
DVASHK	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës
DPASHK	Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës
HK	Harta Kadastrale
KPP	Kartela e pasurisë së paluajtshme, ose Kartela Kadastrale
KRGJSH	Korniza Referuese Gjeodezike e Shqipërisë
OBP	Operatori i Blerjeve të Përqendruara
OPERATORI	Operatori i Regjistrimit Fillestar
PP	Pasuri e paluajtshme
RF	Regjistrim Fillestar
ZK	Zona Kadastrale
ZRPP	Ish Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
ZQRPP	Ish Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
ZVASHK	Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës
ZVRPP	Ish Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

PËRMBAJTJA

1. Qëllimi i projektit dhe baza ligjore
2. Përshkrim i përgjithshëm dhe veçori specifike të projektit
3. Oferta teknike e projektit
4. Palët dhe pjesëmarrësit në procesin e RF
5. Zonat kadastrale pa RF të përfshira në projekt
6. Vendndodhja gjeografike e ZK-ve të përfshira në projekt
7. Kufiri kadastral i ZK-ve të përfshira në projekt
8. Specifikime për ndarje në lote
9. Oferta financiare për projektin
10. Specifikime për përcaktimin e afateve të projektit
11. Kalendari dhe metodologjia e kryrjes së procesit të RF
12. Specifikime për mënyrën e pagesës
13. Fazat dhe aktivitetet e procesit të RF
14. Përgjegjësitë teknike të palëve dhe produktet e punës
 - 14.1 Faza e Parë e Procesit të RF për çdo ZK
 - A. Përgjegjësitë teknike të ASHK gjatë Fazës I
 - B. Përgjegjësitë teknike të Operatorit gjatë Fazës.
 - C. Produkti i Fazës I
 - 14.2 Faza e Dytë e procesit të RF për çdo ZK
 - A. Përgjegjësitë teknike të ASHK gjatë Fazës I
 - B. Përgjegjësitë teknike të Operatorit gjatë Fazës.
 - C. Produkti i Fazës II
 - D. Produkti përfundimtar i procesit të RF
15. Monitorimi dhe kontrolli i procesit të RF
16. Miratimi i produkteve të procesit të RF
 - 16.1 Formular i dorëzimit të produktit të RF për ligjërim
 - 16.2 Raportimi i volumeve të punës së RF
17. Baza ligjore për kryerjen e procesit të RF
18. Shtojca
 - Shtojca 1. Lista e akteve ligjore dhe nënligjore për kryerjen e RF
 - Shtojca 2. Model i formularëve për llogaritjen e vlerës financiare të projektit
 - Shtojca 3. Model për ndarjen në lote të projektit

1. QËLLIMI I PROJEKTIT DHE BAZA LIGJORE

Procesi i Regjistrimit Fillestar i pasurive të paluajtshme është një nga aktivitetet parësore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, përcaktuar në Ligjin nr. 111/2018, dt. 07.02.2019 “Për kadastrën”. Përfundimi i regjistrimit fillestar në të gjithë vendin është një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare për realizimin e Reformës në fushën e të drejtave të pronësisë dhe të Reformës së menaxhimit të integruar të tokës, si dhe një nga kriteret kryesore që duhet të përmbushen nga shteti shqiptar në drejtim të reformimit të shërbimeve publike në lidhje me të drejtat e pronësisë në kuadër të integritetit të Shqipërisë në BE. Gjithashtu realizimi i regjistrimit fillestar i pasurive të paluajtshme në të gjithë territorin e vendit është thelbësor për realizimin e investimeve të parashikuara, si dhe për t’i hapur rrugë investimeve të reja publike apo private në vend.

Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në nenin 9 të Ligjit nr. 111/2018, dt. 07.02.2019 “Për Kadastrën” ka ndërmarrë këtë projekt, i cili ka për qëllim realizimin e procesit të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme në Zonat Kadastrale, që nuk operojnë në sistemin e pasurive të paluajtshme.

Ky projekt përputhet me Dokumentin e politikës “Agjenda kombëtare e reformave 2024–2027” në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”, miratuar me VKM nr. 621, datë 10.10.2024. Një nga Reformat e përcaktuara në këtë dokument është “R.1.1.2 Sigurimi i transparencës dhe efikasitetit të shërbimeve të kadastrës shtetërore, për investitorët dhe qytetarët, dhe ofrimi i një politike të qartë për përdorimin e tokës”, ku si prioritet është përcaktuar regjistrimi fillestar i kryer në 95% të të gjitha zonave kadastrale deri në qershor 2026.

Hapi i parë për zbatimin e Reformës 1.1.2 cituar më lart, parashikon që Agjencia Shtetërore e Kadastrës deri në qershor të vitit 2026 të ketë kryer procesin e Regjistrimit Fillestar për 108 Zona Kadastrale. Në drejtim të përmbushjes së këtij objekti, me Aktin Normativ nr. 5, datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar” është përcaktuar transferimi Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të fondit për të financuar projektin “Regjistrimi fillestar i zonave kadastrale”. Me VKM nr. 82 datë 05.02.2025 “Për miratimin e buxhetit të ASHK për vitin 2025” është miratuar buxheti për projektin “Regjistrim Fillestar për 106 Zona Kadastrale”.

Nga 3058 zona kadastrale që ASHK administron në të gjithë territorin e vendit, evidentohen rreth 225 Zona Kadastrale ku nuk është kryer procesi i Regjistrimit Fillestar (pa përfshirë zonat kadastrale ku ky proces është në vijim). Për realizimin e këtij projekti ASHK ka evidentuar 106 Zona Kadastrale të shtrira kryesisht në qarqet veriore të vendit, ku nuk është kryer procesi i Regjistrimit Fillestar, duke plotësuar kështu 100% regjistrimin fillestar në pjesën e qarqeve veriore në Republikën e Shqipërisë.

Me realizimin e këtij projekti ASHK përmbush objektivin për përfundimin e regjistrimit fillestar në 95% të të gjitha zonave kadastrale të vendit deri në qershor 2026, në respektim të politikave të miratuara të Qeverisë dhe të institucionit.

2. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM DHE VEÇORI SPECIFIKE TË PROJEKTIT

Në këtë projekt përfshihen 106 zona kadastrale, ku nuk është kryer procesi i Regjistrimit Fillestar. Këto zona kadastrale shtrihen në qarqet Kukës (48 ZK), Shkodër (37 ZK), Dibër (12 ZK), Elbasan (5 ZK), Lezhë (3 ZK) Durrës (1 ZK), të cilat për arsye të vështirësive teknike dhe pamundësisë financiare nuk e kanë kryer procesin e RF. Veçoritë që lidhen me vështirësinë e realizimit të këtij procesi apo risqet që duhet të merren parasysh nga ofertuesit në këtë proces janë si me poshtë:

- Zonat kadastrale që janë pjesë e këtij projekti ndodhen kryesisht në terrene të vështira malore. Transporti dhe infrastruktura janë të vështira, parcelat e pasurive janë të vogla dhe të shpërndara edhe në zona të mirëfillta pyjore dhe kullimore.
- Në përgjithësi në këto zona kadastrale nuk ka ndodhur një proces i rregullt i ndarjes së tokës bujqësore me Ligjin 7501. Kjo ka qenë edhe një nga arsyet se përse në këto zona nuk ka ndodhur më parë procesi i regjistrimit fillestar. Për shkak të mungesës së informacioneve të administruara pranë ASHK apo DAMT pranë Këshillit të Qarkut për ndarjen e tokës Bujqësore, është e pritshme që operatorët të hasin vështirësi në identifikimin e pronarëve apo poseduesve të tokave bujqësore.
- Në pjesë të konsiderueshme të këtyre zonave kadastrale ka ndodhur regjistrimi fillestar i sipërfaqeve pyjore dhe kullimore. Ky proces është bazuar kryesisht në ngastrat pyjore të konfiguruar në hartat e shkallëve 1:25000 të ekonomisë pyjore. Në disa raste të evidentuara nga ana e ASHK, brenda tyre pozicionohen parcela bujqësore apo troje të veçuara të cilat do të duhet të identifikohen dhe regjistrohen sipas legjislacionit në fuqi. Gjatë punës për verifikimin e këtyre parcelave mund të paraqitet nevoja për rikonfigurim të parcelave pyjore dhe kullimore.
- Largimi i popullatës nga këto fshatra është një komponent tjetër i rëndësishëm që do të duhet të merret në konsideratë në funksion të vështirësisë së realizimit të procesit.
- Sa më sipër, pritët që në këto zona kadastrale të ketë mangësi të konsiderueshme të informacionit të administruar nga DVASHK-të përkatëse, si harta të vjetra kadastrale, libra ngastrash, apo dokumente që lidhen me ndarjen e tokës bujqësore. Për këtë arsye duhet të merret në konsideratë që numri i pasurive për çdo zonë kadastrale i parashikuar nga ana e ASHK në këto specifikime është shumë i përafërt.

ASHK në këtë proces kërkon që Operatori të ketë të punësuar në stafin e tij ekspertë dhe specialistë të fushës, me profesion inxhinier gjeodet, jurist, IT, që kanë eksperiencë të provuar në fushën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në Shqipëri dhe njohin mirë problematikën që lidhen me regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

3. OFERTA TEKNIKE E PROJEKTIT

Këto Specifikime teknike kanë objekt kryerjen e procesit të Regjistrimit Fillestar (RF) në Zonat Kadastrale në përputhje me ligjin Nr. 111/2018, dt. 7.02.2019 “Për Kadastrën” dhe aktet ligjore dhe nënligjore në zbatim të tij.

Me “Regjistrim Fillestar të kryer” në një zonë kadastrale do të kuptohet plotësimi i të gjitha proceseve të pa kryera dhe/apo të munguara të regjistrimit të të gjitha pasurive të paluajtshme private, apo shtetërore që ndodhen në atë ZK, pavarësisht nga statusi i regjistrimit, statusi i pronësisë dhe problematikat e pasurive të paluajtshme.

Statusi i regjistrimit të pasurive brenda një zone kadastrale mund të jetë:

1. “Regjistrim Fillestar i kryer”.
 - a) Pasuri të regjistruara nga vetë Drejtoria Vendore.
 - b) Pasuri të regjistruara në procese masive të mëparshme (psh. RF i pasurive të paluajtshme të Pyjeve dhe Kullotave në emër të Bashkisë).
2. “Regjistrim Sporadik”,
3. “Regjistrim në Sistemin e Hipotekës” si dhe
4. “Pasuri të pa Regjistruara”.
5. “Regjistrim aktiv”
6. “Regjistrim inaktiv”: KPP të mbyllura për shkak të veprimeve me pasurinë për bashkim, ndarje etj.).

Statusi i pronësisë së pasurive të paluajtshme në një zonë kadastrale është:

- a) Pasuri të paluajtshme me pronar. Këtu përfshihen pasuri të paluajtshme me dokumentacion ligjor të fitimit të pronësisë, që regjistrohen në pronësi të subjekteve private apo subjekteve/institucioneve publike.
- b) Pasuri të paluajtshme pa pronar. Këtu përfshihen pasuri të paluajtshme pa dokumentacion ligjor të fitimit të pronësisë, që evidentohen në HK dhe pasqyrohen në KPP “Shtet”.

Për këto pasuri mund të ketë dokumentacion për të drejta të tjera reale apo informacion tjetër, që pasqyrohen në regjistrin kadastral sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nënligjore.

Në kategoritë e mësipërme mund të hasen problematika të ndryshme, si:

- dokumente të pa regjistruara në KPP dhe HK;
- gabime teknike dhe ligjore në regjistrimin e pasurive;
- regjistrime të cilat nuk përmbushin standardet e caktuara;
- arkivi i dokumenteve manuale pjesërisht në sistemin e ri të regjistrimit (SRPP) dhe pjesërisht në sistemin e vjetër të regjistrimit (Hipotekë);
- dokumente pronësie të pa skanuara ose skanim jo sipas standardeve
- etj.

Në produktin përfundimtar të RF për një Zonë Kadastrale, për të gjitha pasuritë e paluajtshme pa përjashtim, në formë manuale dhe dixhitale, do të paraqitet gjendja e përditësuar deri në datën e përfundimit të Afishimit Publik në të tre komponentët e sistemit të ri të regjistrimit:

- në Kartelën Kadastrale (KPP) (në formë digjitale)
- në Hartën Kadastrale (në formë digjitale)
- në Arkivin e dokumenteve të pronësisë (në formë manuale dhe digjitale).

Sistemi i vjetër i Hipotekës (aty ku ekziston) do të mbyllet dhe të gjitha dokumentet e arkivuara sipas këtij sistemi do të jenë transferuar dhe arkivuar sipas sistemit të ri të regjistrimit. Mbyllja e Sistemit të Hipotekës do të shoqërohet me krijimin dhe evidentimin e lidhjes midis të dy sistemeve të arkivimit të dokumenteve, sipas standardit.

Produkti përfundimtar për secilën Zonë Kadastrale do të jetë në përputhje me të gjithë kuadrin ligjor në fuqi që rregullon regjistrin kadastral dhe do të përfshijë të gjitha elementet e përcaktuara në standardet e miratuara për produktet që administrohen në Bazën Shtetërore të të dhënave Kadastrale – ALBSCAD, që është Kadastra në format digjital.

Çdo produkt paraprak apo përfundimtar, do të jetë objekt i kontrollit nga strukturat e ASHK sipas procedurave në fuqi, të miratuara nga institucioni.

Aktet ligjore e nënligjore, si dhe rregulloret / udhëzimet që do të zbatohen për kryrjen e procesit të RF të parashikuar në këto specifikime teknike, janë listuar në Shtojcën 1 “Lista e dokumentave tekniko ligjore”. Gjatë procesit mund të miratohen akte të reja apo mund të ketë ndryshime në aktet nënligjore ekzistuese, të cilat duhet t’i bëhen me dije Operatorit në kohë reale.

4. PALËT DHE PJESËMARRËSIT NË PROCESIN E RF

Palët kontraktuese në procesin e RF janë:

1. Subjekti i përzgjedhur nga OBP për kryerjen e shërbimeve të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme (Operatori i Regjistrimit Fillestar).
2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e përfaqësuar nga:
 - a. Drejtoria e Përgjithshme e ASHK në nivel qendror, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues dhe monitorues i projektit.
 - b. Drejtoritë Vendore të ASHK (si dhe ZVASHK-të përkatëse) në nivel vendor, që janë përgjegjëse për kontrollin e cilësisë dhe marrjen në dorëzim të produktit të RF për çdo ZK objekt i projektit.

Në këtë projekt pritet të përfshihen si pjesëmarrës në aktivitetet e procesit të RF:

- Subjektet që kanë të drejta pronësore, apo të drejta të tjera reale në Zonat Kadastrale të përfshira në proces.
- Institucionet / subjektet që lëshojnë dhe krijojnë akte ligjore të regjistrueshme në regjistrin kadastral.
- Organet e Vetëqeverisjes Vendore

5. ZONAT KADASTRALE PA RF TË PËRFSHIRA NË PROJEKT

Zonat Kadastrale ku nuk është kryer më parë Regjistrimi Fillestar, të cilat do t'i nënshtrohen procesit të Regjistrimit Fillestar në kuadër të këtij projekti janë listuar në tabelën e mëposhtme. Të dhënat për statusin e regjistrimit fillestar të këtyre zonave janë konfirmuar zyrtarisht nga Drejtoritë Vendore të ASHK dhe Zyrtat Vendore të ASHK përkatëse gjatë hartimit të këtyre specifikimeve teknike.

Tabela 1. Të dhënat e 106 Zonave Kadastrale objekt i këtij projekti


NR	ZK	EMER	DVASHK / ZVASHK	BASHKIA	QARKU
1	1111	BARDHAJ REÇ	DIBËR	DIBËR	DIBËR
2	1662	FUSHE E VOGEL	DIBËR	DIBËR	DIBËR
3	1889	GURE REÇ	DIBËR	DIBËR	DIBËR
4	1973	HURDHE REÇ	DIBËR	DIBËR	DIBËR
5	2774	NDERSHENE	DIBËR	DIBËR	DIBËR
6	3004	POCEST	DIBËR	DIBËR	DIBËR
7	3080	QAFE MURRE	DIBËR	DIBËR	DIBËR
8	3482	SOHODOLL	DIBËR	DIBËR	DIBËR
9	3483	SOHODOLL I VOGEL	DIBËR	DIBËR	DIBËR
10	4002	ÇERENEC I EPERM	DIBËR / ZV BULQIZË	BULQIZË	DIBËR
11	1743	GJINOVEC	DIBËR / ZV BULQIZË	BULQIZË	DIBËR
12	2501	LUBALESH	DIBËR / ZV BULQIZË	BULQIZË	DIBËR
13	1118	BARKANESH	DURRËS-KAVAJË-KRUJË	KRUJË	DURRËS
14	1474	DERSTIL	ELBASAN	ELBASAN	ELBASAN
15	1785	GODOLESH	ELBASAN	ELBASAN	ELBASAN
16	1899	GURI I ZI	ELBASAN	ELBASAN	ELBASAN
17	2355	LABINOT-FUSHE	ELBASAN	ELBASAN	ELBASAN
18	2432	LETANI	ELBASAN	ELBASAN	ELBASAN
19	1278	BRENOGE	KUKËS	HAS	KUKËS
20	1349	CAHAN	KUKËS	HAS	KUKËS
21	1599	FAJZE	KUKËS	HAS	KUKËS
22	1683	GAJREP	KUKËS	HAS	KUKËS
23	1788	GOLAJ	KUKËS	HAS	KUKËS
24	2152	KISHAJ	KUKËS	HAS	KUKËS
25	2431	LETAJ	KUKËS	HAS	KUKËS
26	2463	LIQENI I KUQ	KUKËS	HAS	KUKËS
27	2674	METALIAJ	KUKËS	HAS	KUKËS
28	2731	MUJAJ	KUKËS	HAS	KUKËS
29	2797	NIKOLIQ	KUKËS	HAS	KUKËS
30	2910	PERAJ	KUKËS	HAS	KUKËS
31	2950	PEROLLAJ	KUKËS	HAS	KUKËS
32	2983	PLANI PATES	KUKËS	HAS	KUKËS
33	3012	POGAJ	KUKËS	HAS	KUKËS

NR	ZK	EMER	DVASHK / ZVASHK	BASHKIA	QARKU
34	3085	QARR	KUKËS	HAS	KUKËS
35	3634	TREGTAN	KUKËS	HAS	KUKËS
36	3794	VLAHEN	KUKËS	HAS	KUKËS
37	3821	VRANISHT	KUKËS	HAS	KUKËS
38	3873	ZAHRISHT	KUKËS	HAS	KUKËS
39	3911	ZGJEÇ	KUKËS	HAS	KUKËS
40	1011	ALIAJ	KUKËS	KUKËS	KUKËS
41	1338	BUZEMADHE	KUKËS	KUKËS	KUKËS
42	1350	ÇAJE	KUKËS	KUKËS	KUKËS
43	2290	KRYEMADH	KUKËS	KUKËS	KUKËS
44	3406	SHPAT	KUKËS	KUKËS	KUKËS
45	3851	XHAFERAJ	KUKËS	KUKËS	KUKËS
46	1223	BLLADE	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
47	1259	BRADOSHNIÇE	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
48	1283	BRISË	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
49	1432	CURRAJ I POSHTEM	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
50	1456	DEGE	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
51	1761	GJONPEPAJ	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
52	1862	GRI E RE	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
53	1993	JAHO SALIHI	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
54	2146	KERRNAJ	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
55	2251	KOVAÇE	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
56	2403	LEKBIBAJ	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
57	2407	LEKURTAJ	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
58	2602	MARKAJ	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
59	2761	MYHEJAN	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
60	2865	PALÇE	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
61	2875	PAPAJ	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
62	2911	PERAJ	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
63	3986	RAGAM-LLUGAJ	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
64	3253	SALCE	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
65	3288	SELIMAJ	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
66	3588	TETAJ	KUKËS	TROPOJË	KUKËS
67	1304	BUKMIRE	LEZHË	MIRDITË	LEZHË
68	2534	LURTH	LEZHË	MIRDITË	LEZHË
69	2773	NDERSHEN	LEZHË	MIRDITË	LEZHË
70	3988	OROSH	SHKODËR	FUSHË ARRËS	SHKODËR
71	1000	ABAT	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
72	1264	BRASHTË	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
73	1289	BRUÇAJ	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR


NR	ZK	EMER	DVASHK / ZVASHK	BASHKIA	QARKU
74	1448	DARRAGJAT	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
75	1714	GIMAJ	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
76	1769	GJURAJ-BOKS	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
77	2400	LEKAJ	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
78	2492	LOTAJ	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
79	2564	MALI GJYMTIT	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
80	2775	NDREJAJ	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
81	2777	NENMAVRIQ	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
82	2791	NICAJ-SHALE	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
83	2792	NICAJ-SHOSHE	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
84	2859	PALAJ	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
85	2894	PECAJ	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
86	2904	PENTAR	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
87	2907	PEPSUMAJ	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
88	2979	PLAN	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
89	3842	VUKSANAJ	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
90	3853	XHAN	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
91	2551	MALAGJIKAJVALL	SHKODËR	VAU I DEJËS	SHKODËR
92	2860	PALAJ-GUSHTE	SHKODËR	VAU I DEJËS	SHKODËR
93	3307	SERME	SHKODËR	VAU I DEJËS	SHKODËR
94	3571	TELUME-KLLOGJEN	SHKODËR	VAU I DEJËS	SHKODËR
95	3607	T'OPLAN	SHKODËR	VAU I DEJËS	SHKODËR
96	3672	UKBIBAJ	SHKODËR	VAU I DEJËS	SHKODËR
97	3772	VILE	SHKODËR	VAU I DEJËS	SHKODËR
98	1345	BZHETE	SHKODËR / ZV MALËSI E MADHE	MALËSI E MADHE	SHKODËR
99	1346	BZHETE-MAKAJ	SHKODËR / ZV MALËSI E MADHE	MALËSI E MADHE	SHKODËR
100	2199	KOKPAPAJ	SHKODËR / ZV MALËSI E MADHE	MALËSI E MADHE	SHKODËR
101	2258	KOZHJE	SHKODËR / ZV MALËSI E MADHE	MALËSI E MADHE	SHKODËR
102	2487	LOHE E POSHTME	SHKODËR / ZV MALËSI E MADHE	MALËSI E MADHE	SHKODËR
103	2668	MESHQERRE	SHKODËR / ZV MALËSI E MADHE	MALËSI E MADHE	SHKODËR
104	3170	REPISHT	SHKODËR / ZV MALËSI E MADHE	MALËSI E MADHE	SHKODËR
105	3697	VAJUSH	SHKODËR / ZV MALËSI E MADHE	MALËSI E MADHE	SHKODËR
106	3837	VUÇ-KURTAJ	SHKODËR / ZV MALËSI E MADHE	MALËSI E MADHE	SHKODËR

6. VENDNDODHJA GJEOGRAFIKE E ZONAVE KADASTRALE TË PËRFSHIRA NË PROJEKT

6.1 Vendndodhja gjeografike e zonave kadastrale



6.2 Vendndodhja gjeografike e zonave kadastrale në ortofoto




7. KUFIRI KADASTRAL I ZONAVE KADASTRALE TË PËRFSHIRA NË PROJEKT


Kufiri kadastral i secilës ZK i paraqitur në këto specifikime është paraprak dhe jo zyrtar.


Kufiri kadastral i çdo ZK do të konsultohet me organet e vetëqeverisjes vendore dhe do të miratohet nga DVASHK përkatëse gjatë periudhës së kryerjes së punimeve fushore.


Kufiri kadastral përfundimar për çdo ZK do të përcaktohet dhe ligjërohet në fund të procesit, pasi të jenë ezauruar problemet me pasuritë e paluajtshme të ZK-ve kufitare që përfshihen në këtë proces, si dhe me pasuritë e paluajtshme të ZK-ve kufitare që janë në sistem (ku ka përfunduar RF).


Në grafikët e mëposhtëm janë paraqitur kufijtë orientues, që identifikojnë Zonat Kadastrale të përfshira në këtë proces, sipas pozicionimit të tyre në territorin e Bashkive përkatëse.

















8. SPECIFIKIME PËR NDARJEN NË LOTE

Theksojmë se afati i parashikuar për përfundimin e punimeve të këtij projekti është maj 2026 (shiko Kreun 10 “Specifikime për përcaktimin e afateve të projektit”), që është një afat i përcaktuar në bazë të objektivave të qeverisë shqiptare dhe të vetë institucionit, dhe që nuk mund të ndryshohet, pavarësisht datës se kur do të lidhet kontrata.

Me qëllim respektimin e këtij afati, si dhe në referim të nenit 39 të ligjit nr. 162/2020, dt. 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, vlerësohet se projekti mund të realizohet i ndarë në lote.

Kriter për ndarjen në lote mund të jetë:

- Grupimi i ZK-ve sipas Bashkive
- Grupimi i ZK-ve sipas DVASHK / ZVASHK
- Grupimi i ZK-ve sipas Vendndodhjes gjeografike të ZK-ve

Në rast se do të përcaktohet ndarja në lote e projektit, duhet të merren parasysh kushtet e mëposhtme teknike:

- Të respektohet tërësia territoriale e Zonës Kadastrale (pra një ZK nuk mund të ndahet në lote të ndryshme).
- Brenda një kontrate/loti të përfshihen mundësisht sa më shumë Zona Kadastrale që janë kufitare me njëra – tjetrën. Kjo për të siguruar që problemet me kufirin e këtyre zonave kadastrale të zgjidhen përbrenda një kontrate / loti.

Shpërndarja e volumit të punës duhet të vlerësohet jo vetëm nga ana matematike (me numër pasurie për secilën kontratë / lot), por edhe duke vlerësuar vështirësitë e punimeve për matje fushore për çdo ZK, të kushtëzuar nga terreni i vështirë gjeografik, apo dhe faktorë të tjerë të shjeguara në Kreun “2. Përshkrim i përgjithshëm dhe veçori specifike të projektit”.

Në Shtojcën 3 është paraqitur propozimi i modelit për ndarjen në lote të këtij projekti, që bazohet në kriterin e ndarjes territoriale sipas Bashkive. Referuar kushteve dhe kriterëve të sipërcituara është vlerësuar se kjo ndarje mundëson në masën më të madhe grupimin në një lot të sa më shumë Zonave Kadastrale që kufizojnë njëra – tjetrën, pavarësisht se ato administrohen nga DVASHK të ndryshme. Kjo është e rëndësishme sepse përcaktimi i kufirit përfundimtar i çdo Zone Kadastrale do të konsultohet gjatë procesit të RF edhe me organet e vetëqeverisjes vendore. Zonat Kadastrale që janë të shkëputura territorialisht janë grupuar sipas Bashkive kufitare, apo të afërta me njëra-tjetrën, duke respektuar kriterin e vendndodhjes gjeografike të Zonave Kadastrale, por duke shmangur fragmentimin e projektit në lote me objekt minimal të volumeve të punës.

Në këtë ndarje në lote është respektuar një shpërndarje logjike e volumeve të punës në referim të specifikave që lidhen me terrenin e ZK-ve të një loti, si dhe në vlerësim të mundësive reale të një Operatori në burime njerëzore dhe logjistike për të realizuar shërbimet e kërkuara brenda afateve të përcaktuara në këto specifikime.

Sa më lart është vlerësuar se ndarja e sugjeruar në lote sipas Bashkive është mënyra e vetme që përmbledh maksimalisht kushtet dhe kriteret për ndarjen në lote të përcaktuara në këto specifikime dhe që respekton një proporcionalitet logjik të kapaciteteve reale të Operatorëve me volumet e punës dhe produktet e pritshme brenda afateve të përcaktuara për realizimin e këtij projekti.

9. OFERTA FINANCIARE PËR PROJEKTIN

Në lidhje me përcaktimin e njësisë bazë për llogaritjen e vlerës financiare të projektit, specifikojmë disa elemente vlerësimi:

- Objekt i projektit janë Zona Kadastrale rurale, të cilat nuk paraqesin diversitet të llojit të pasurive që trajtohen, pasi mbizotëron lloji i pasurisë “tokë bujqësore”.
- Në këto ZK rurale numri i transaksioneve apo veprimeve me pasuritë e paluajtshme nuk pritet të jetë i konsiderueshëm. Regjistrimet inaktive verifikohen dhe trajtohen në dokumentacion tekniko – ligjor sikurse dhe regjistrimet aktive.
- Në këto ZK puna fushore për pasuritë e paluajtshme me status “në pronësi” apo “shtet” paraqitet me të njëjtin nivel vështirësie, për shkak të faktorëve të shpjeguar në Kreun 2, si dhe referuar aktiviteteve të punës të përshkruara në Kreun 13 dhe 14.
- Në këto ZK numri i regjistrimeve ekzistuese si në sistemin e ri ashtu edhe në sistemin e hipotekës të kryera nga DVASHK si rregull është i vogël. Këto regjistrime do të jenë objekt verifikimi në terren, si dhe në dokumentacionin tekniko-ligjor sikurse dhe pasuritë e patrajuara më parë.

Sa më lart puna për trajtimin e informacionit tekniko – ligjor për pasuritë e paluajtshme të këtyre ZK-ve në përgjithësi paraqitet me natyrë të përafërt, pavarësisht statusit të tyre të përshkruar në Kreun 3. “Ofertat teknike e projektit”. Për rrjedhojë si njësi bazë për vlerësimin e ofertës financiare për këtë proces do të merret 1 (një) pasuri e paluajtshme, që si rregull në produkt paraqitet në 1 (një) kartelë kadastrale (KPP).

Numri i pritshëm i pasurive të paluajtshme për çdo zonë kadastrale, i pasqyruar në tabelën 2 të shtojcës 3, është konfirmuar nga Drejtoritë Vendore përkatëse. Duke vlerësuar teknikisht këtë informacion sqarojmë se ky numër është i përafërt dhe mund të rezultojë i ndryshëm (më i madh ose më i vogël) nga volumi i punës që do të realizohet gjatë procesit. Kjo për arsyet e përshkruara në Kreun 2 “Përshkrim i përgjithshëm dhe veçori specifike të projektit”, si dhe duke konsideruar statusin e regjistrimit, statusin e pronësisë dhe problematikat specifike të pasurive të paluajtshme për çdo ZK, të përshkruara në Kreun 3 “Oferta teknike e projektit”.

Për efekt pagese në numrin e pasurive nuk do të llogariten pasuritë/kartelat pjesë e produktit të Regjistrimit Fillestar të Pyje / Kullotave në emër të Bashkisë, pavarësisht se gjatë këtij procesi në këto kartela ekzistuese mund të bëhen ndryshime në funksion të korrigjimeve/saktësimeve, apo ndryshime të nevojshme, si domosdoshmëri për trajtimin e pasurive të reja. Kjo së pari për shkak se këto pasuri janë ligjëruar në një procedurë të plotë Regjistrimi Fillestar dhe së dyti, sepse aktet nënligjore që përcaktojnë pasuritë pyje/kullota në emër të Bashkisë trajtojnë pasuri të ekonomive pyjore dhe kullosore me sipërfaqe shumë të mëdha, për të cilat verifikimi për efekt Përmirësimi të RF do ta vështirësonte dhe zgjaste procesin e RF objekt të këtij projekti.

Sa më lart:

- Oferta financiare për këtë projekt dhe termat e kontraktimit në funksion të pagesave do të bazohen tek çmimi për 1 (një) pasuri të paluajtshme.
- Pagesa përfundimtare do të kryhet sipas volumeve të punës që do të realizohen për çdo ZK (sipas formularit Rezultatet e regjistrimit fillestar, pika 16.2).
- Nuk do të llogariten në vlerë pasuritë e produktit të RF të Pyje/Kullotave në emër të Bashkive.

Në shtojcën 2 është sugjeruar model i tabelës për pasqyrimin e të dhënave në funksion të përcaktimit të vlerës financiare të procesit.

10. SPECIFIKIME PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE TË PROJEKTIT

Kohëzgjatja e parashikuar e punës për një Zonë Kadastrale, duke konsideruar natyrën e ndryshme të problematikave në secilën ZK, llogaritet përafërsisht 7 – 13 muaj kalendarikë:

- Rreth 3-5 muaj përgatitja e produktit të Fazës I
- Rreth 2 muaj për përgatitjen dhe kryerjen e Afishimit Publik
- Rreth 1-2 muaj për përfundimin e Fazës II të procesit (përfshirë dorëzimin e materialeve dhe miratimin e produkteve të Zonës Kadastrale)
- Të paktën 1 - 4 muaj. Ligjërimi i RF dhe ngarkimi i produktit përfundimtar në ALBSCAD. Kjo periudhë kushtëzohet nga ecuria e punës për ngarkimin e produkteve të RF për secilën ZK në sistemin ALBSCAD.

Në afatet e mësipërme përfshihet edhe periudha e nevojshme për kryerjen e kontrollit të produkteve nga ASHK sipas procedurave në fuqi.

Në këto afate nuk është llogaritur koha që mund të shtohet për shkak të kthimit të produkteve të pakorrigjuara më shumë se një herë. Në këtë rast në kontratë mund të parashikohen penaltete, nëse nga operatori dorëzohet një produkt i përsëritur, i pakorrigjuar.

Afati i parashikuar për përfundimin e punimeve nga Operatori për të gjitha Zonat kadastrale që përfshihen në kontratë është 31 Maj 2026 (përfshirë muajin Maj 2026), në respektim të politikave të Qeverisë shqiptare të sqaruara në Kreun 1 “Qëllimi i projektit”. Deri në 31 maj 2026 duhet të kenë përfunduar punimet e Fazës II për të gjitha Zonat Kadastrale dhe produkti i korrigjuar i Fazës II të jetë dorëzuar dhe miratuar nga ASHK sipas procedurave përkatëse.

Kohëzgjatja e punimeve në total (edhe në rastin e ndarjes me lote) do të përcaktohet në kontratë, duke llogaritur që deri më 31 Maj 2026 të jetë miratuar produkti i Fazës II nga DVASHK për të gjitha ZK-të dhe që produkti përfundimtar i RF i ligjëruar mund të përmbillet përtej kësaj date, të paktën 1 - 4 muaj nga data 31 Maj 2026, që do të përcaktohet në kontratën përkatëse.

Kohëzgjatja e Fazave të procesit, si dhe dorëzimi i produkteve të punës objekt i kontratës do të bëhet për çdo zonë kadastrale sipas afateve të përcaktuara në kalendarin e punimeve (shiko Kreun 11 “Kalendari dhe metodologjia e kryerjes së procesit të RF”).

11. KALENDARI DHE METODOLOGJIA E KRYERJES SË PROCESIT TË RF

Ofertuesi do të paraqesë në ofertën teknike Kalendarin e Punimeve, i cili do të jetë i detajuar sipas fazave dhe aktiviteteve të përcaktuara në këto specifikime, si dhe sipas metodologjisë së punës të përshkruar prej tij. Kalendarin e punimeve do të përfshihet në kontratë me përmbajtjen e paraqitur në ofertën teknike.

Në kalendarin e punimeve duhet të parashikohet që:

- Brenda 2 muajve nga data e lidhjes së kontratës puna të ketë filluar në të gjitha ZK-të objekt kontrate.
- Deri në 31 mars 2026 të jenë dorëzuar për kontroll produktet e Fazës II për të gjitha Zonat Kadastrale objekt i kontratës. Kjo është e domosdoshme për të siguruar periudhën e nevojshëm për kontroll dhe korrigjim të gabimeve të produkteve.
- Deri në 31 maj 2026 duhet të kenë përfunduar punimet e Fazës II për të gjitha ZK-të dhe të jetë miratuar produkti i Fazës II.
- Të përcaktohet 20 ditë për kontrollin e Produktit të Fazës I nga ASHK.
- Të përcaktohet 15 ditë për kontrollin e Produktit të Fazës II nga ASHK.

Operatori do të paraqesë një Grafik Pune të përgjithshëm, ku të jepet metodologjia e shpërndarjes së punës së parashikuar nga ofertuesi për çdo lot/kontratë brenda afatit të përcaktuar në Kreun 10 “Specifikime për përcaktimin e afateve të projektit”.

(Draft model) Kalendarin e punimeve për një Zonë Kadastrale.

Numri dhe emri i ZK: _____ Bashkia: _____

Emri i Operatorit: _____

Data e Fillimit të punimeve: _____ Data e Përfundimit të punimeve: _____

Faza	Përshkrimi i aktivitetit	FAZA I						FAZA II					
		2	4	6	8	10	Etj.						
		15	30	45	60	75	Etj.						
F I	1. Mobilizimi dhe grumbullimi i Dokumentacionit												
	2. (Të renditen aktivitetet sipas Fazave të procesit si dhe metodologjisë së Operatorit)												
F II	1. Afishimi Publik												
	2. (Të renditen aktivitetet sipas Fazave të procesit si dhe metodologjisë së Operatorit)												

(Draft model) Grafiku i përgjithshëm i punimeve

Emri i Operatorit: _____

Data e Fillimit të punimeve: _____ Data e Përfundimit të punimeve: _____

Nr.	Bashkia	DVASHK	Nr. i ZK	Emri i ZK	Afatet sipas kontratës	(ditë / javë)							
						2	4	6	8	10	Etj.		
						15	30	45	60	75	Etj.		
1									F1		AP		FII
2								F1			AP		FII

Modelet e mësipërme të Kalendarit dhe Grafikut të punimeve mund të detajohen nga Operatori për të paraqitur sa më qartë metodologjinë e tij për kryerjen e punimeve për çdo ZK dhe për kontratën në total.

12. SPECIFIKIME PËR MËNYRËN E PAGESËS

Duke vlerësuar natyrën e punës për çdo aktivitet të Regjistrimit Fillestar, sugjerohet që pagesa ndaj Operatorit të realizohet sipas fazave të punës, përkundrejt dokumentacionit provues për volumet e punës, si dhe aprovues për përfundimin e punimeve të fazës përkatëse për produkte sipas standarteve të miratuara. Në tabelën e mëposhtme paraqitet mënyra bazë për ndarjen e pagesës, referuar Fazave të procesit dhe të aktiviteteve e produkteve të pritshme nga Operatori, të specifikuar në Kreu 13. Fazat e punës dhe përgjegjësitë teknike të palëve të këtyre specifikimeve.

Fazat e punës	Pagesa në %	Volumi i punës	Dokumentacioni për lëvrimin e pagesës
Faza 1	40 %	Llogaritur sipas numrit të pasurive që rezultojnë nga produkti.	Dokumenti i aprovimit të produkteve të punës për regjistrimin fillestar, Faza I
Faza 2	60 %	Llogaritur sipas numrit të pasurive të trajtuara në fazën II, duke rakorduar edhe me pasuritë e fazës 1.	Dokumenti i aprovimit të produkteve të punës së Kontraktorit për regjistrimin fillestar, Faza II

Për të siguruar mbarëvajtjen e punë teknike të DVASHK për ligjërimin dhe përgatitjen e produktit përfundimtar të RF, ASHK do të parashikojë një garanci financiare prej 5% të vlerës së kontratës , e cila do të mbahet për një periudhë 6 mujore nga përfundimi i fazës së dytë të procesit dhe do të lëvrohet në bazë të shkresës konfirmuese për përfundimin me sukses të RF , që do të lëshohet nga ana e DPASHK për cdo zonë kadastrale.

13. FAZAT DHE AKTIVITET E PUNËS

Për realizimin e procesit të RF nga Palët në proces do të zbatohen rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Ligjin Nr. 111/2018, dt. 07.02.2019 "Për Kadastrën", aktet ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe aktet e brendshme të miratuara nga institucioni, që rregullojnë këtë proces.

Procesi i Regjistrimit Fillestar për çdo ZK, referuar kuadrit ligor në fuqi, do të përmbajë fazat e mëposhtme:

Faza	Aktiviteti	Palët e përfshira
Faza 1	1. Mobilizimi dhe grumbullimi i Dokumentacionit: - Mobilizimi i stafit për të organizuar aspektet e fillimit të punës si logjistika, ekipi i nevojshëm, organizimi i një takimi fillestar me aktorët kyç të interesit (Operator, Bashki, ASHK), përgatitja e një plani të detajuar pune. - Grumbullimi dhe vënia në dispozicion të Operatorit e të gjitha dokumenteve (manuale dhe dixhitale), të cilat lidhen me RF.	DVASHK OPERATORI
	2. Informimi Publik - Kryerja e fushatës së informimit publik për sensibilizimin në masë të gjerë të subjekteve, të interesuar mbi procesin e RF për zonën kadastrale, që do të shtrihet gjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit. - Informimi i pronarëve gjatë procesit të matjeve në terren për përcaktimin e kufirit të ZK, kufijve të pasurive të paluajtshme dhe grumbullimit të informacionit nga pronarët. - Informimi i njësive të qeverisjes vendore ku shtrihet RF	OPERATORI DVASHK
	3. Arkivi i dokumenteve të pronësisë dhe të të drejtave të tjera reale. - Skanimi i çdo faqe të dokumentacionit tekniko-ligjor të pasurive, sipas standardeve të përshkruara në Dokumentin nr. 2905/1 prot., datë 26.10.2012 të ZQRPP "Standardet e kopjeve dixhitale të dokumentave tekniko-ligjor", - Krijimi i arkivit digjital dhe manual të dokumentave të pronësisë për të gjitha pasuritë, që i përkasin zonës kadastrale.	OPERATORI DHE DVASHK
	4. Përgatitja e Hartës Kadastrale (HK) dhe Librit të Ngastrave (LN) - Saktësimi i kufirit të ZK nëpërmjet matjeve në terren dhe miratimi nga DVASHK. - Kryerja e matjeve fushore të kufijve të pasurive të paluajtshme private dhe shtetërore, përfshirë të gjitha ndërtesat (formale dhe informale) - Marrja e informacionit nga subjektet për të drejtat mbi pronën që kanë në pronësi apo që e posedojnë dhe pasqyrimi i tij në LN.	OPERATORI DHE DVASHK
	5. Përfshirja e Regjistrimit Fillestar ekzistues në Regjistrimin Fillestar. - Regjistrimeve ekzistuese të ligjëruara nga DVASHK. - Për regjistrimet ekzistuese të kryera me procese të pjesshme të RF për zonën kadastrale (psh. produktet e pyje/kullotave në emër të Bashkisë), do të përfshihet produkti ekzistues, që është ligjësuar sipas legjislacionit të kohës.	OPERATORI DHE DVASHK

Faza 1	Në këto produkte do të bëhen ndryshime, korrigjime, saktësime vetëm në kartelat ekzistuese, në funksion të trajtimit të pasurive të reja, sipas dokumentacionit tekniko-ligjor përkatës. Çdo ndryshim në këto kartela do të kryhet në bazë të urdhrit të DVASHK përkatëse. Raportim i DVASHK në vazhdimësi për të gjitha ndryshimet e kryera në regjistrimet ekzistuese	
	6. Përfshirja e Regjistrimit Sporadik në Regjistrimin Fillestar, që konsiston (por pa u kufizuar) në proceset e mëposhtëm: - Krijimi i bazës dixhitale të KPP-ve Sporadike - Kontrolli total logjik, teknik dhe ligjor i Regjistrimit Sporadik. - Korrigjimi i gabimeve teknike dhe ligjore. Për korrigjimet të cilat duhet të bëhen në bazë të urdhrave të DVASHK, Operatori përgatit draftet përkatëse për t'u miratuar nga Drejtori i DVASHK-së. - Regjistrimi në KPP i të gjitha dokumenteve të regjistruara në Sistemin e Hipotekës (aty ku ekziston) por të pa regjistruara në Kartelat Sporadike. - Përditësimi i KPP-ve sporadike me veprimet e munguara (përfshirë inskriptet, transkriptet, notimet, etj.).	OPERATORI DHE DVASHK
	7. Përgatitja e Kartelave Kadastrale (kartela e pasurive të paluajtshme, KPP) për pasuritë e patrajuara më parë - Për të gjitha pasuritë e paluajtshme të ZK, private dhe shtetërore, për të cilat nuk është hapur KPP nga DVASHK, do të hapen kartela nga Operatori, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme. - Operatori do të trajtojë të gjithë dokumentacionin që është marrë në dorëzim nga DVASHK. Në rast se dokumentacioni ka mangësi në elementet e formës dhe përmbajtjes dokumentacioni do të trajtohen sipas rregullave në fuqi për këto raste - Në rastet kur pasuritë e identifikuar janë të kategorisë “tokë bujqësore”, në kartelë duhet të paraqitet informacioni i nevojshëm në zbatim të VKM 1182 dt. 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore”. Për ecurinë e këtij aktiviteti do të sigurohet Raportim i DVASHK në vazhdimësi.	OPERATORI
	8. Dorëzimi i Produktit të Fazës I të regjistrimit fillestar në format dixhital, sipas standardit nr. 134/1 prot., dt. 07.01.2014 i ZQRPP “Standardi i përkohshëm i shkëmbimit të të dhënave për regjistrimin fillestar”.	OPERATORI
	9. Kontrolli i Cilësisë së Produktit të Fazës I të regjistrimit fillestar. (Në kalendarin e punimeve për çdo ZK do të parashikohet një periudhë 15 ditore për këtë proces). Lëshimi i dokumentit të aprovimit të produkteve të punës për regjistrimin fillestar, Faza I	DVASHK DPASHK

Faza 2	10. Afishimi Publik, sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën” dhe aktet ligjore dhe nënligjore të tij. - Përgatitja e procesit të Afishimit Publik - Afishimi 45 ditë i informacionit të ZK për konsultim publik - Njoftim publik për kryerjen e procesit të Afishimit. -	OPERATORI DVASHK
	11. Dorëzimi i Produktit të Fazës II të regjistrimit fillestar në format digjital	OPERATORI
	12. Kontrolli i Cilësisë së Produktit të Fazës II të regjistrimit fillestar. (Në kalendarin e punimeve për çdo ZK do të parashikohet një periudhë 15 ditore për këtë proces). Raporti për produktin e konsideruar “i pranueshëm” nga DVASHK i dërgohet për korrigjim dhe plotësim Operatorit.	DVASHK DPASHK
	13. Dorëzimi i produktit dhe i materialeve të punës të ZK (digjitale dhe manuale) Miratimi i punës - Dorëzimi i dokumentacionit (manual dhe dixhital) sipas “Deklaratës së Përfundimit të Punimeve” - Printime në letër sipas kërkesave të ASHK (inventare, procesverbale, informacione etj.). Në proces nuk përfshihet printim në letër i kartelave kadastrale dhe i hartës kadastrale. - Plotësimi i produktit në formën dixhitale sipas standardit përkatës (DVASHK verifikon që janë reflektuar problematikat e konstatuara) - Nënshkrimi nga ana e titullarit të DVASHK i të gjithë dokumentacionit që është prodhuar gjatë procesit nga operatori për llogari të ASHK - Miratimi i produkteve dhe lëshimi i dokumentit të Pranimit dhe miratimit të punës së Kontraktorit për Fazën II.	OPERATORI DVASHK
	14. Ligjërimi i produktit - Ligjërimi i KPP-ve dhe HK me vulë digjitale nga DVASHK. - Mbyllja e funksioneve të Sistemit të Hipotekës. -	DVASHK DPASHK
	15. Sistemimi dhe ngarkimi i produktit përfundimtar në ALBSCAD Depozitimi i produktit në DVASHK - Evidentimi dhe eliminimi i problemeve dhe mangësive në produkt në bashkëpunim me Operatorin - Arkivimi i dokumentacionit në DVASHK - Ngarkimi i Produktit Përfundimtar Dixhital në Sistemin ALBSCAD. - Lëshimi i dokumentit kofirmues për përfundimin e RF lëshuar nga DPASHK.	DVASHK DPASHK OPERATORI

14. PËRGJEGJËSITË TEKNIKE TË PALËVE DHE PRODUKTET E PUNËS

Në respektim të kuadrit ligjor në fuqi, për të përfunduar Regjistrimin Fillestar në zonat kadastrale objekt i këtij projekti, nga secila Palë në proces pritet realizimi i detyrave dhe aktiviteteve të nevojshme, duke përfshirë, por jo domosdoshmërisht të kufizuara në çështjet si më poshtë.

ASHK, si palë në proces, në përputhje me kompetencat dhe detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 111/2018, dt. 07.02.2019 “Për kadastrën” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, do të ndjekë procesin në nivel vendor nëpërmjet Drejtorive Vendore përkatëse në cilësinë e administratorit të regjistrimit kadastral, dhe në nivel qendror nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme në cilësinë e menaxhuesit të kontratës dhe monitoruesit të projektit.

Operatori, në zbatim të kushteve të kontratës, do të respektojë legjislacionin dhe procedurat në fuqi për kryerjen e procesit të RF, si dhe për trajtimin e pasurive të paluajtshme në regjistrin kadastral. Çdo material që i vihet në dispozicion Operatorit nga ASHK apo nga palë të treta në lidhje me këtë proces, si dhe çdo produkt i përgatitur prej tij gjatë këtij procesi për çdo zonë kadastrale është pjesë e regjistrimit kadastral, që përbën Bazën e të Dhënave Shtetërore të Pasurive të Paluajtshme. Operatori do të garantojë gjatë dhe pas këtij procesi respektimin e legjislacionit në fuqi për sigurimin dhe konfidencialitetin e informacionit që përbën Bazën e të Dhënave Shtetërore të Pasurive të Paluajtshme.

14.1. FAZA 1 (E PARË) E PROCESIT TË RF PËR ÇDO ZK

A. Përgjegjësitë teknike të ASHK gjatë fazës I

ASHK, është përgjegjëse dhe do t’i sigurojë Operatorit, në mënyrë që ai të kryejë në kohën dhe mënyrën e duhur Regjistrimin Fillestar në zonat kadastrale objekt i këtij procesi, si më poshtë:

1. Një ambjent pune dhe pajisje të përshtatshme brenda DVASHK
2. Punonjës të DVASHK si persona të autorizuar për marrëdhëniet me Operatorin dhe me rol kryesor në procesin e kontrollit. Punonjësit do të koordinojnë veprimet e ndërsjellta ndërmjet DVASHK dhe Operatorit, si dhe do të kryejë cdo veprim administrativ në funksion të mbarëvajtjen e këtij procesi.
3. Kopje të akteve ligjore dhe nënligjore dhe dokumenteve të tjera, që përcaktojnë rregulla për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, standardet dhe procedurat e procesit të RF.
4. Programet kompjuterike, që lidhen me procesin e RF, në mënyrë që produkti të hartohet dhe kontrollohet sipas standardeve të miratuara.
5. Akses të kontrolluar Operatorit për skanimin e dokumentacionit teknik dhe ligjor të pasurive të zonës kadastrale (dokumente origjinale të arkivit të referencave, hartave bazë, librave të ngastrave, formularëve A dhe B të regjistrimeve në sistemin e hipotekës, kartelave kadastrale dhe të çdo dokumentacioni tjetër të nevojshëm, të arkivuar në DVASHK.
6. Akses të kontrolluar Operatorit në skedarët digjitale të dokumenteve të pronësisë.
7. Akses të kontrolluar Operatorit për regjistrimin e numrave të referencave mbi dokumentet origjinale dhe regjistrat e arkivit të Hipotekës.

8. Në rastin kur ka dokumente që mungojnë, ose janë të paregjistruara dhe disponohen nga pronarët, të cilat janë identifikuar nga Operatori gjatë punës së kryer në terren, subjekti i interesuar do t'i dorëzojë ato në DVASHK përkatëse. DVASHK do të evidentojë këto dokumente në librin e pranimit të dokumteve të RF për atë ZK, do t'i përfshijë në dokumentet e arkivit të ZK dhe do t'i vihen në dispozicion Operatorit për trajtim gjatë procesit të RF.
9. Në rastin e aplikimeve të bëra gjatë procesit të RF, DVASHK do t'i vërë këto dokumente në dispozicion të Operatorit, i cili nga ana e tij do të bëjë skanimin e dokumenteve, trajtimin e dosjes, përgatitjen e kartelës kadastrale, hedhjen në hartën kadastrale provizore, përgatitjen e përgjigjes për kërkesën e aplikuesit brenda afateve të DVASHK. DVASHK kontrollon regjistrimin dhe i kthen përgjigjen aplikuesit.
10. Nuk lejohet të lihen “në dispozicion” numra për dokumentet e arkivit (referenca), numra për pasuritë në HK dhe për volume e faqe të kartelave kadastrale.
11. Bashkëpunim me Operatorin për informimin publik të Regjistrimit Fillestar, duke përdorur çdo mjet informimi në shërbim të këtij qëllimi për periudhën 45 ditore të Afishimi Publik.
12. Përgjigje në kohë për të gjitha çështjet e paraqitura me shkrim nga Operatori.
13. Kontroll në vazhdimësi dhe “një për një” të kartelave ekzistuese, sporadike dhe kartelave të reja të përgatitura nga Operatori.
14. Kontroll të aktiviteteve të RF sipas rregullave në fuqi për kontrollin e procesit.
15. Kontrollin dhe miratimin e produkteve të punës së Fazës I, sipas rregullave në fuqi.
16. Çdo komunikim shkresor i DVASHK me Operatorin, apo me të tretë, do t'i komunikohet DPASHK për dijeni.

B. Përgjegjësitë teknike të Operatorit gjatë Fazës I

1. Operatori është përgjegjës për mirë-administrimin e dokumentacionit, të vënë në dispozicion nga ASHK.
2. Operatori duhet të zhvillojë një program për informimin e publikut në lidhje me procesin e RF në ZK të caktuar, nëpërmjet posterave, fletëpalosjeve dhe mënyrave të tjera gjatë të gjithë kohëzgjatjes së procesit të RF deri në përfundim të Afishimit Publik, sipas standardeve të përcaktuara. Operatori duhet t'u sugjerojë pronarëve vendosjen e shenjave në kufijtë e pronave, veçanërisht për tokat bujqësore.
3. Operatori duhet të kryejë matje fushore dhe verifikime direkte për krijimin e HK dhe Librit të Ngastrave. Sistemi i koordinatave të Hartës Kadastrale të krijuar do të jetë sipas KRGJSH. Në rast se operatori realizon ortofoto në shërbim të këtij procesi, ky material i vendoset në dispozicion ASHK.
Në Hartën Kadastrale Operatori duhet të identifikojë:
 - kufirin e zonës kadastrale, i cili duhet të konsultohet me organet e pushtetit vendor dhe të miratohet nga DVASHK gjatë periudhës së kryerjes së matjeve fushore,

- kufijtë fizikë të pasurive të paluajtshme dhe ndërtesave private, shtetërore dhe informale, duke aplikuar rregulloret dhe instruksionet për përgatitjen e HK.
- numrin e pasurisë së paluajtshme.

Duhet të ruhen numrat e pasurive të Hartës Kadastrale të punës dhe Librit të Ngastrave ekzistues sipas Udhëzuesit “Për Regjistrimin Fillestar në Zonat Urbane”. Për numrat e pasurive të tokës bujqësore do të përdoren numrat e parcelës kadastrale të pandarë sipas hartës së DAMT.

Për matjet fushore duhet të përfshihet në produkt materiali/dokumenti i matjeve fushore sipas metodës së punës (digjital ose i skanuar).

Matjet fushore do të pasqyrohen në ortofoton e fundit (të krijuar nga ASIG), në bazë të së cilës do të krijohet HK. Për krijimin e HK gjatë këtij procesi, Operatori mund të realizojë ortofoto, të cilat duhet t’i vendosen në dispozicion ASHK në produktet e punës.

Elementet e tjera të HK, përveç pasurive të paluajtshme, përcaktohen në standardet e miratuara me dokumentin nr. 134/1 prot., dt. 07.01.2014 të ZQRPP “Standardi i përkohshëm i shkëmbimit të të dhënave për regjistrimin fillestar”. Ky standard identifikon gjithashtu atributet që do të regjistrohen për elementet e të dhënave (përfshirë të dhënat gjeografike) dhe rregullat llogjike që duhet të përmbushin këto attribute.

4. Krijimi i arkivit digjital të të gjitha dokumenteve të pronësisë dhe të të drejtave të tjera reale mbi pronën për pasuritë e ZK (pavarësisht statusit të regjistrimit të pasurive) sipas Standardeve Teknike të Informacionit Digjital. Kur imazhet e skanuara janë dhënë nga ASHK dhe formati nuk është sipas standardit, është përgjegjësi e Operatorit t’i konvertojë dhe t’i përshtasë këto imazhe. Në rastet kur dokumentet fizike mungojnë, do të krijohet “file” me numrin e referencës së dokumentit dhe me fjalën “MUNGON”, për shembull: “1345_00000001_MUNGON”.
5. Krijimi i arkivit manual të dokumenteve duke transferuar nga sistemi i hipotekës në sistemin e ri të regjistrimit të gjitha dokumentet të cilat i përkasin pasurive të zonës kadastrale, pavarësisht statusit të regjistrimit të pasurive. Dokumentet manuale do të renditen duke filluar me numër reference “00000001” dhe në vazhdimësi (pa lejuar boshllëqe dhe/ose mbivendosje të numrave të referencave). Në setin e secilës referencë do të jetë një inventar i dokumenteve përbërëse sipas formularit të përcaktuar për këtë qëllim. Në rast se dokumenti fizik mungon, në dosje do të vendoset formulari i inventarit në të cilin regjistrohet shënimi për mungesën e dokumentit.
6. Operatori do të përpilojë lista, ku do të evidentohet lidhje ndërmjet të dy sistemeve të arkivimit të dokumenteve (arkivit të referencave të ZK dhe arkivit të dokumenteve të Hipotekës), për të mundësuar gjetjen lehtësisht të dokumenteve për çdo regjistrim. Këto lista do të përfshihen të skanuara në produkt.
7. Operatori do të bëjë lidhjen e të dy sistemeve të regjistrimit edhe në KPP, ku do të plotësohen të dhënat për regjistrimet në sistemin e hipotekës për çdo regjistrim në kartelën kadastrale.
8. Përfshirja në produkt e Regjistrimit Fillestar ekzistues, të kryer nga DVASHK. Këtu mund të përfshihen regjistrime me procedurë të veçantë për pasuritë “tokë

bujqësore”, si dhe regjistrime të tjera të kryera nga DVASHK. Disa nga aspektet kryesore gjatë këtij procesi janë (por pa u kufizuar vetëm në to) si më poshtë:

- Digjitalizimi i regjistrimeve ekzistuese
- Kontrolli logjik i Kartelave dixhitale dhe i lidhjes KPP - HK dhe korrigjimi në KPP manuale dhe dixhitale i gabimeve të evidentuara.
- Përditësimi i KPP-ve manuale dhe dixhitale të RF ekzistues me transaksionet e munguara (përfshirë inskriptet, transkriptet, notimet, etj.).
- Përgatitja e draft - urdhrave për Drejtorin e DVASHK për korrigjime teknike dhe plotësime të RF ekzistues.
- Raportim pranë DVASHK për të gjitha ndryshimet, korrigjimet teknike dhe plotësimet e bëra në HK dhe KPP-të e RF ekzistues.
- Në rastet kur mungon baza digjitale e KPP-ve të apartamenteve të privatizuara, regjistrimi i tyre do të konsiderohet sikurse pasuritë e reja (të pa trajtuara nga DVASHK).

9. Përfshirja në produkt e Regjistrimit Fillestar ekzistues të kryer me procese të pjesshme. Për produktet e pyje/kullotave në emër të Bashkisë, do të përfshihet produkti ekzistues, që është ligjërues sipas legjislacionit të kohës, duke eliminuar gabimet e mundshme që mund të rezultojnë nga kontrolli logjik i këtij produkti. Në kartelat dhe hartat e këtyre produkteve do të bëhen ndryshime, korrigjime, saktësime vetëm në funksion të trajtimit të pasurive të reja, sipas dokumentacionit tekniko-ligjor përkatës. Çdo ndryshim do të kryhet në bazë të urdhrat arsyetuar të DVASHK përkatëse.
10. Përfshirja në produkt e Regjistrimit Sporadik. Disa nga aspektet kryesore gjatë këtij procesi janë (pa u kufizuar vetëm në to) si më poshtë:
 - Krijimi i bazës dixhitale të Kartelave Sporadike
 - Kontrolli total teknik dhe ligjor i Regjistrimit Sporadik.
 - Korrigjimi i gabimeve teknike dhe ligjore. Për korrigjimet të cilat duhet të bëhen në bazë të Urdhrave, Operatori përgatit draftet përkatëse për t'u miratuar nga Drejtori i DVASHK përkatëse.
 - Regjistrimi në Kartela i të gjitha dokumenteve të regjistruara në Sistemin e Hipotekës, por të pa regjistruara në KPP Sporadike.
 - KPP manuale sporadike do të jenë në përdorim nga DVASHK deri në përfundim të Regjistrimit Fillestar Sistematik për të kryer shërbimet ndaj klientëve dhe për kontrollet e punës së Operatorit.
11. Përgatitja e Kartelave për çdo pasuri të paluajtshme private dhe shtetërore të pa trajtuar nga DVASHK, bazuar në Librin e Ngastrave dhe në dokumentet e pronësisë së pasurive të paluajtshme në përputhje me aktet ligjore e nënligjore. Operatori do të regjistrojë edhe pasuritë informale sipas rregullave përkatëse.
12. Dorëzimi periodikisht në format digjital, pranë DVASHK, të KPP-ve të reja si dhe KPP-ve ekzistuese apo sporadike të korrigjuara, me qëllim kontrollin e tyre “një për një” nga ZVRPP.
13. Operatori do të kryejë regjistrimin e pasurive dhe transaksioneve, për të cilat aplikohet gjatë procesit të Regjistrimit Fillestar. Aplikimi dhe dorëzimi i përgjigjes së aplikuesit bëhen vetëm nga DVASHK.
14. Për të gjitha çështjet për të cilat Operatori mund të ketë paqartësi ose probleme gjatë procesit, komunikimi do të jetë me shkrim, duke ju drejtuar DVASHK përkatëse dhe DPASHK. Çdo komunikim shkresor i Operatorit me DVASHK, apo me palë të treta, do t'i komunikohet për dijeni DPASHK.

C. Produktet e Fazës I

Në përfundim të Fazës së Parë, Operatori do të dorëzojë në mënyrë digjitale produktet e punës. Materiali duhet të jetë sipas standardeve të miratuara me dokumentin nr. 134/1 prot., dt. 07.01.2014 të ZQRPP “Standardi i përkohshëm i shkëmbimit të të dhënave për regjistrimin fillestar”. Produkti digjital duhet të jetë i përmbedhur në një dosje, ku në emërtesë të pasqyrohet numri dhe emri i ZK dhe Faza I.

Produkti duhet të ketë elementet (foldera), si më poshtë:

1. Matjet fushore dhe hartimi
 - Libri i Ngastrave
 - Skica
 - Harta bazë fushore
 - Të tjera _____
2. Arkivi digjital i çdo zone kadastrale që përmban imazhet e skanuara të dokumenteve të pronësisë dhe dokumenteve të tjera që i referohen punës së Regjistrimit Fillestar – ky arkiv digjital duhet të përmbushë Standardet e miratuara me dokumentin nr. 2905/1 prot., datë 26.10.2012 të ZQRPP “Standardet e kopjeve dixhitale të dokumentave tekniko-ligjor”.
3. Harta Kadastrale dixhitale dhe “shape file” (lidhja HK me KPP) sipas standardeve të miratuara me dokumentin nr. 134/1 prot., dt. 07.01.2014 të ZQRPP “Standardi i përkohshëm i shkëmbimit të të dhënave për regjistrimin fillestar”.
4. Libri i Ngastrave digjital dhe informacioni manual dhe digjital për ndërtimet informale.
5. Kartelat digjitale sipas Standardit të Përkohshëm të Shkëmbimit të të Dhënave të Regjistrimit Fillestar.
6. Kartelat manuale ekzistuese (të Regjistrimit ekzistues dhe sporadik), të skanuara, me korrigjimet sipas Urdhrit të DVASHK.
7. “Metadata”, e firmosur, në letër dhe e skanuar, e përgatitur për Regjistrimin Fillestar në çdo zonë kadastrale, sipas Standardit të Përkohshëm Shkëmbimit të të Dhënave të Regjistrimit Fillestar.
8. Raportet e kontrolleve digjitale të kryera nga Operatori.

Në produkt do të përfshihet në folder të veçantë çdo dokumentacion administrativ, korrespondencë dhe informacion që ka lidhje me procesin dhe i krijuar deri në datën e dorëzimit të produktit, shoqëruar me relacion ku të listohet i gjithë ky dokumentacion.

14.2 FAZA II (E DYTË) E PROCESIT TË RF

Gjatë Fazës II të procesit të RF përgjegjësitë teknike të Palëve janë si më poshtë:

A. Përgjegjësitë teknike të ASHK gjatë Fazës II

1. Bashkëpunim me Operatorin për vënien në zbatim të nenit 31 të Ligjit nr. 111/2018, dt. 07.02.2019 “Për kadastrën”, i cili parashikon afishimin 45 ditor për konsultim publik, që do të shoqërohet edhe me njoftim publik.
2. Monitorim për mbarrëvajtjen e Afishimit Publik për 45 ditë në bashkëpunim me organet e qeverisjes lokale, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 111/2018, dt. 07.02.2019 “Për kadastrën” dhe akteve rregulluese të procesit.

3. DVASHK organizon punën për pranimin e dokumenteve tekniko – ligjore origjinale të dorëzuara nga të interesuarit gjatë të gjithë periudhës së Afishimit Publik, duke i evidentuar në librin përkatës të pranimin të dokumentacionit për procesin e Regjistrimit Fillestar. Ky dokumentacion i vihet në dispozicion Operatorit për trajtim në produkt sipas procedurës.
4. Bashkëpunim me Operatorin për korrigjimin e gabimeve materiale, analizimin dhe zgjidhjen e problemeve të paraqitura nga subjektet e interesuara gjatë periudhës së Afishimit Publik.
5. Kontrolli i procesit të Afishimit Publik.
6. Mbyllja e regjistrimeve në regjistrat e Hipotekës nëpërmjet vendosjes së numrit të zonës kadastrale dhe numrit të dokumentit sipas arkivit të ZK (numri i referencës) në kolonën e fundit të çdo regjistrimi në të gjithë regjistrat e Hipotekës.
7. Kontrollin dhe miratimin e produkteve të Fazës II.
8. DVASHK merr në dorëzim produktin e korrigjuar të Fazës II, si dhe të gjithë materialin e ZK manual dhe digjital, sipas “Proces – Verbalit mbi Dorëzimin në DVASHK të Dokumentacionit të RF” (shiko Kreun 16)

DVASHK verifikon që janë reflektuar problematikat e konstatuara nga ASHK dhe që produkti në formën digjitale është sipas standardit të kërkuar për ngarkim në ALBSCAD.

9. Ligjërimin e produkteve të Regjistrimit Fillestar. DVASHK do të ligjërojë me firmë dhe vulë elektronike kartelat kadastrale dhe Hartën Kadastrale në format digjital .pdf.

DVASHK mund të printojë dhe arkivojë kopje fizike të dokumentacionit të ligjëruar. Ky dokumentacion fizik është vetëm për administrim në arkivin e DVASHK si informacioni i RF të pasurive të paluajtshme dhe nuk do të përdoret nga DVASHK për të kryer veprime mbi to.

10. DVASHK sistemon dhe arkivon produktin në arkivin fizik të zonës kadastrale. Materialet me të cilat ka punuar DVASHK përpara përfundimit të procesit të Regjistrimit Fillestar (Harta pune, KPP manuale të Regjistrimit Fillestar ekzistues dhe atij sporadik, Regjistra të sistemit të Hipotekës) do të arkivohen.

Pas përfundimit të Regjistrimit Fillestar do të kryhen veprime vetëm mbi produktin e përfutur nga procesi i Regjistrimit Fillestar në sistemin digjital.

11. DPASHK ngarkon produktin përfundimtar në sistemin digjital të regjistrat kadastral, dhe siguron që informacioni është i plotë për t’u trajtuar në sistemin operativ (multifunksional).

B. Përgjegjësitë teknike të Operatori gjatë Fazës II:

1. Kryerja e Afishimit Publik në përputhje me ligjin nr. 111/2018, dt. 07.02.2019 “Për kadastrën” dhe me procedurat standarde të miratuara për këtë proces.

Për Afishimin Publik Operatori do të sigurojnë një ambjent / zyrë brenda zonës kadastrale, që do të jetë e hapur gjatë gjithë kohëzgjatjes së Afishimit Publik (përfshirë ditët e pushimeve) në përputhje me grafikun e punës që do të propozohet nga Operatori dhe do të miratohet nga DVASHK në përfundim të Fazës I.

Personeli i pritjes së klientëve duhet të ketë kualifikimin e duhur lidhur me procesin e RF dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme, me qëllim realizimin me efikasitet të këtij procesi, ku duhet t’i jepet orientim dhe sqarim problematikave të paraqitura nga pronarët dhe personat e tjerë të interesuar gjatë këtij procesi.

Gjatë Afishimit Publik Operatori do të mbajë regjistrin e vizitave dhe të pretendimeve të personave të interesuar që do të paraqiten gjatë të gjithë periudhës së AP:

- Konsultimi me palët pretenduese lidhur me informacionin në KPP dhe HK me qëllim qartësimin dhe korrigjimin e gabimeve.
 - Plotësimi i arkivit të dokumenteve manuale dhe dixhitale me dokumentet e grumbulluara gjatë Afishimit Publik dhe trajtimi në produkt i këtij dokumentacioni (dokumentacioni vihet në dispozicion nga DVASHK).
 - Korrigjimi i gabimeve materiale të konstatuara gjatë Afishimit Publik
 - Përgatitja e draft-urdrave për DVASHK në rastet e nevojshme.
 - Kthimi i përgjigjeve (me shkrim) subjekteve të cilat kanë paraqitur ankesë.
2. Bashkëpunimi me DVASHK përkatëse për të kryer njoftimin/informimin publik të pronarëve për procesin e Afishimit Publik të Regjistrimit Fillestar.
 3. Korrigjimi në produkt i gabimeve të konstatuara në raportet e DVASHK dhe DPASHK.
 4. Dorëzimi pranë DVASHK dhe DPASHK të produktit digjital të Fazës II, me qëllim kontrollin sipas procedurave përkatëse.
 5. Kur produkti konsiderohet i pranueshëm nga DVASHK, Operatori
 - Plotëson dhe korrigjon produktin sipas raporteve të kontrollit të ASHK,
 - Kryen printime në letër sipas kërkesave të ASHK (urdhra, lista, inventare, procesverbale, informacione etj.). Në proces nuk përfshihet printim në letër i kartelave kadastrale dhe i hartës kadastrale.
 - Dorëzon të gjithë dokumentacionin (manual dhe digjital) në DVASHK sipas “Proces – Verbalit mbi Dorëzimin në DVASHK të Dokumentacionit të RF” (shiko Kreun 16)
 6. I përgjigjet ASHK për të gjitha problemet teknike që mund të dalin gjatë përgatitjes së produktit për ligjërime, deri në ngarkimin e produktit përfundimtar të punës për RF të Zonës kadastrale në bazën e të dhënave të ALBSCAD.

C. Produktet e Fazës II

Produkti digjital i Fazës II do të jetë i të njëjtit standard si produkti i Fazës I. Materiali duhet të jetë i përbledhur në një dosje, ku në emërtesë të pasqyrohet numri dhe emri i ZK dhe Faza II.. Produkti duhet të ketë elementet (foldera) si në produktin e Fazës I, duke shtuar folderin “AFISHIMI PUBLIK”.

Produkti duhet të jetë i plotë, të jenë eliminuar në të mangësitë dhe gabimet e konstatuara në produktin e Fazës I, të jetë përfshirë i gjithë informacioni i Afishimit Publik, dhe të jetë i përditësuar me të gjithë dokumentacionin/informacionin administrativ shoqërues mbi Zonën Kadastrale.

D. Produkti përfundimtar i RF i procesit të RF

Produktet e Fazës së Dytë, të cilat dorëzohen nga Operatori sipas përcaktimeve më lart, do të përpunohen nga DVASHK për të kryer ligjërimin e produktit sipas nenit 32 të ligjit 111/2018, dt. 07.02.2019 “Për Kadastrën” dhe ngarkimin e produktit në sistemin e kadastrës digjitale ALBSCAD.

Produkti përfundimtar duhet të jetë në përputhje me dokumentin nr. 134/1 prot., dt. 07.01.2014 të ZQRPP “Standardi i përkohshëm i shkëmbimit të të dhënave për regjistrimin fillestar”. Në produkt do të përfshihet në formë digjitale çdo material që prodhon DVASHK gjatë fazës përmbyllëse të procesit.

Një kopje digjitale e dokumenteve të produktit përfundimtar do të dorëzohet nga Operatori pranë DPASHK.

Produkti përfundimtar do të konfirmohet nga DPASHK, e cila do të dokumentojë sipas formatit të miratuar ligjërimin dhe ngarkimin e produktit në ALBSCAD.

Me konfirmimin e produktit nga DPASHK procesi i RF për zonën kadastrale përkatëse konsiderohet i përfunduar.

15. MONITORIMI DHE KONTROLLI I PROCESIT TË RF

Monitorimi i punës së Operatorit do të kryhet nga aktorët e përfshirë në proces në përputhje me Ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën” dhe aktet ligjore dhe nënligjore në zbatim të tij. Aktualisht kontrollet e detyrueshme për tu zbatuar janë ato që përshkruhen në dokumentin nr. 892 dt. 07.02.2008 “Procedurat e kontrollit për regjistrimin fillestar “ të ish DPASHK.

Monitorimi do të bëhet gjatë të gjitha fazave të RF dhe do të përfshijë (por nuk do të kufizohet në) proceset e mëposhtëm:

1. Përfshirja e Regjistrimit Fillestar ekzistues (i përditësuar dhe korrigjuar),
2. Përfshirja e Regjistrimit Sporadik (i përditësuar dhe korrigjuar),
3. Përditësimi i Hartave Kadastrale nëpërmjet matjeve fushore,
4. Përditësimi i Librit të Ngastrave,
5. Përgatitja e Hartave Kadastrale,
6. Skanimi i dokumenteve të pronësisë,
7. Përpunimi teknik dhe ligjor i informacionit, përfshirë edhe ndërtimet informale,
8. Përgatitja e KPP-ve,
9. Lidhja e KPP-ve me HK-në,
10. Krijimi i arkivit manual të dokumenteve të pronësisë (transferimi i dokumenteve nga sistemi i Hipotekës në Sistemin e ri të Regjistrimit),
11. Afishimi Publik,
12. Dorëzimi i dokumentacionit në letër në DVASHK,
13. Dorëzimi i produkteve finale dixhitale në DVASHK dhe DPASHK
14. Ligjërimi i Regjistrimit Fillestar, Arkivimi i dokumentacionit në DVASHK dhe pushimi i funksioneve të Sistemit të Hipotekës,
15. Ngarkimi në ALBSCAD i produktit përfundimtar.

Në rast se standardet, për secilën fazë, nuk janë arritur nga Operatori, DPASHK do të ketë të drejtën të kërkojë që puna të ribëhet pa kosto shtesë, përpara kalimit në fazën pasardhëse.

Gjatë dorëzimit të produkteve finale të Fazës II, DVASHK (Drejtori) do të bëjë një seri kontrollesh të përshkruara në “Procedurat e Kontrollit të Regjistrimit Fillestar”. Operatori do të plotësojë çdo mungesë në produktet e punës të konstatuar nga kontrolli.

16. MIRATIMI I PRODUKTEVE TË PROCESIT TË RF

DPASHK do të njoftojë Operatorin brenda 20 ditëve nga marrja e produkteve të Fazës I dhe të Fazës II për vendimin lidhur me miratimin apo mospranimin e produkteve të punës, dokumenteve dhe raporteve. Rezultatet e kontrollit do të pasqyrohen në raportin teknik të detajuar, të formuluar sipas procedurës në fuqi për kryerjen e kontrollit të produkteve të RF. DPASHK do të japë arsyet për mospranim të produkteve, ose do të kërkojë të bëhen korrigjime apo ndryshime në produkt, referuar raporteve përkatëse.

Kur një produkt pune, është miratuar nga ASHK dhe është objekt korrigjimesh apo ndryshimesh për t'u kryer nga Operatori, DPASHK do të përcaktojë një periudhë kohe për kryerjen e korrigjimeve dhe ndryshimeve të kërkuara.

Në rast se pas korrigjimit të produktit nga Operatori, gjatë rikontrollit nga ASHK do të konstatohen të njëjtat gabime apo problematika, si dhe në rast vonese në dorëzimin e produkteve për kontroll, ndaj Operatorit mund të parashikohen penaltete në mënyrën dhe masën e përcaktuar në Kontratë.

Produktet e punës për çdo Fazë të procesit do të miratohen sipas Formularëve standard për miratimin e produkteve të punës për regjistrimin fillestar të përcaktuar me dokumentin nr. 892, datë 07.02.2008 të ZQRPP “Procedurat e Kontrollit për Regjistrimin Fillestar”.

Dorëzimi nga Operatori i produkteve të miratuara të Fazës II dhe materialeve të punës për Zonën Kadastrale, do të bëhet sipas formularit “Proces –verbal mbi Dorëzimin në DVASHK të dokumentacionit të Regjistrimit Fillestar”, hartuar sipas Udhëzuesit nr. 77, dt. 08.05.2003 të ZQRPP “Për regjistrimin fillestar në Zonat Urbane”, përshtatur me përcaktimet e ligjit nr. 111/2018, dt. 07.02.2019 “Për kadastrën” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij (Pika 16.1).

16.1 FORMULAR I DORËZIMIT TË PRODUKTIT TË RF PËR LIGJËRIM**PROCES – VERBAL****Mbi Dorëzimin në DVASHK të dokumentacionit të Regjistrimit Fillestar
Zona Kadastrale _____**

I mbajtur sot, më datë ____/____/____ në DVASHK _____ ndërmjet Operatorit, përfaqësuar nga Z. _____ dhe Drejtorit të DVASHK Z. _____, për dorëzimin e dokumentacionit të Regjistrimit Fillestar të Zonës Kadastrale Nr. _____ në _____ (Regjistrimi Fillestar përfundoi më datë ____/____/____)

1. Dokumentet e pronësisë (origjinale) me numrat e referencave arkivore nga _____ deri _____,
2. Dokumentet e pronësisë (si dhe Urdhrat e DVASHK për korrigjimet në Kartelat e RF ekzistues dhe atij Sporadik manuale) digjitale sipas Standardit Teknik të Informacionit Dixhital (të Skanimit),
3. Harta Kadastrale digjitale dhe “shape file” (lidhja HK me KPP), sipas Standardit të Përkohshëm Shkëmbimit të të Dhënave të Regjistrimit Fillestar,
4. KPP digjitale sipas Standardit të Përkohshëm të Shkëmbimit të të Dhënave të Regjistrimit Fillestar, nga Vol. ____ Fq. ____ deri në Vol. ____ Fq. ____
5. “Metadata”, të firmosura, në letër dhe të skanuara, sipas Standardit të Përkohshëm Shkëmbimit të të Dhënave të Regjistrimit Fillestar,
6. Libri i inventarit të dokumenteve me referencat e të dy sistemeve (Sistemit të Hipotekës dhe Sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme)
7. Libri me pretendimet e zgjidhura dhe të pazgjidhura
8. Dokumente hartografike dhe të tjera të vëna në dispozicion të Operatorit për RF _____,
9. Printime të listave me informacion mbi pasuritë, ku të përfshihen:
 - a. Lista rendore e pronarëve të pasurive
 - b. Lista me informacionin e pronësisë ose bashkëpronësisë sipas Seksionit të pronësisë të KPP, renditur sipas pronarëve (rend alfabetik).
 - c. Lista me informacionin e pronësisë ose bashkëpronësisë për pasuritë që përfshihen në pasuritë Pallat (apartament, bodrum, studio, njësi, etj.)
 - d. Lista e pasurive të paluajtshme renditur sipas numrit të pasurive
 - e. Lista me informacionin mbi të drejtat e tjera reale mbi pasurinë sipas Seksionit të të drejtave të tjera reale të KPP.
 - f. Lista me informacionin mbi kufizimet mbi pasurinë sipas Seksionit të kufizimeve të pronësisë në KPP.
 - g. Lista e pasurive me pronar "Shtet".
 - h. Evidenca përmbledhëse sipas modelit të mëposhtëm.

Ky proces verbal hartohet në tre kopje (Një kopje për DPASHK)

DORËZUESI
Operatori _____

MARRËSI në DORËZIM
Drejtori i DVASHK _____

Në këtë formular nuk është përfshirë dorëzimi i KPP-ve dhe HK të printuara (në format digjital), pasi ky proces do të kryhet nga DVASHK gjatë ligjëritimit të produkteve të RF.

16.2 RAPORTIMI E VOLUMEVE TË PUNËS SË RF

Volumet/Rezultatet e punës raportohen sipas formularit të mëposhtëm. Ky formular do të konfirmohet nga DVASHK dhe do të jetë pjesë e dokumentacionit provues për kryerjen e pagesave sipas mënyrës së përcaktuar në kontratë.

Në kushtet e kontratës duhet të përcaktohet mënyra e pagesës në rast se numri i pasurive të realizuara për çdo ZK si dhe për çdo kontratë/lot del më i madh nga parashikimi.

REZULTATET E REGJISTRIMIT FILLESTAR

Qyteti _____ Zona Kadastrale Nr. _____

Datë ____/____/____

Nr.	EMERTIMI	TOTALI	%
A	1. Pasuri gjithsej		100
	2. Pasuri në pronësi private		
	3. Pasuri në pronësi të personave juridikë		
	4. Pasuri me pronësi "Pronar i Pa Vërtetuar"		
	5. Pasuri në pronësi shtetërore		
B	1. Pasuri Apartamente		
	2. Pasuri truall		
	3. Pasuri truall + ndërtesë		
	17. Pasuri Rrugë		
	5. Pasuri Pyje / kullota		
C	1. Pasuri të regjistruara pa kufizime		
	- në pronësi private		
	- në pronësi shtetërore		
D	1. Pasuri me pronësi të ndryshme të truallit dhe të ndërtesës		
	- shtet – privat		
	- privat – privat		
	2. Pasuri të mbivendosura		
	3. Pasuri të okupuara:		
	- shtetërore		
	- private		
	4. Ndërtime informale		
E	1. Pasuri me regjistrim ekzistues nga DVASHK		
	2. Pasuri të paluajtshme (KPP të reja) të trajtuara nga Operatori		
	3. Pasuri të paluajtshme të trajtuara nga procesi i RF të Pyje / kullotave në emër të Bashkisë ¹		

¹ Pasuritë e paluajtshme të trajtuara nga procesi i RF të pyje/kullotave në emër të Bashkisë nuk përfshihen në pagesë.

17. BAZA LIGJORE PËR KRYERJEN E PROCESIT TË RF

ASHK do të vërë në dispozicion të Operatorit në formë dixhitale bazën ligjore që do të shërbejë për kryerjen e procesit të Regjistrimit Fillestar Sistemik. Baza ligjore do të përfshijë Ligjin 111/2018, dt. 07.02.2019 “Për Kadastrën”, aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe rregulloret, udhëzuesit standardet teknike dhe akte të tjera të miratuara nga DPASHK dhe ZQRPP, që rregullojnë regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe procesin e Regjistrimit Fillestar.

Aktet e vëna në dispozicion nga ASHK përmbajnë të gjitha kërkesat dhe standardet për kryerjen e procesit të Regjistrimit Fillestar. Është përgjegjësi e Operatorit për të siguruar që puna e tij dhe produktet e punës të jenë në përputhje me këto akte.

Me nënshkrimin e kontratës Operatorit do t’i vihet në dispozicion lista dhe seti i plotë i akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë regjistrimin e pasurive të paluajtshme, si dhe e akteve të brendshme të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK apo ZQRPP në lidhje me procesin e Regjistrimit Fillestar, të cilat janë në fuqi në kohën e nënshkrimit të kontratës.

Për çdo akt të ri, apo ndryshim në aktet ekzistuese nënligjore gjatë procesit të RF, DPASHK do të njoftojë Operatorin brenda 5 ditëve me shkrim.

Në shtojcën 1. është dhënë Lista paraprake e akteve ligjore dhe nënligjore për regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Kjo listë nuk është shteruese, dhe në të do të përfshihet çdo akt ligjor dhe nënligjor që përmban rregulla për regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe që do të miratohet deri në përfundim të procesit të Regjistrimit Fillestar.

SHTOJCA 1. Në referim të Kreut 17. Baza ligjore për kryerjen e procesit të RF

Lista e akteve ligjore dhe nënligjore për kryerjen e RF (orientuese)

Nr	Numri dhe data e aktit	Emërtimi i Aktit ligjor / nënligjor
1	Ligj nr. 111/2018, datë 07.02.2019	“Për Kadastrën”.
2	Ligj nr. 20/2020, datë 05.03.2020	“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.
3	VKM nr.1174, datë 24.12.2020	“Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese”.
4	VKM nr.1182, datë 24.12.2020	“Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore”.
5	VKM nr.1040, datë 25.11.2020	“Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”.
6	VKM nr.1178, datë 24.12.2020	“Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”.
7	VKM nr.1180, datë 24.12.2020	“Për përcaktimin e procedurave të veçanta të legalizimit në favor të poseduesve të objekteve me shkelje të lejes së ndërtimit, si dhe rregullat për përfundimin e procedurës nga subjektet dhe/ose shoqëritë ndërtuese apo investitore”.
8	VKM nr.827, datë 30.09.2020	“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë, të objekteve pa titull pronësie, trojeve të tyre funksionale dhe të oborreve në përdorim”.
9	VKM nr.1181, datë 24.12.2020	“Për miratimin e rregullave të krijimit, përdorimit, administrimit, ruajtjes dhe ndërveprimit të bazës së të dhënave të proceseve kalimtare të pronësisë”.
10	VKM nr.1189, datë 24.12.2020	“Për rregullat e kalimit të pronësisë, afatet, mënyrën e llogaritjes dhe të njoftimit të pagesës së truallit, zbritjet që përfitohen, si dhe miratimin e modelit të aktit të kalimit të pronësisë, në zonat e stimuluar”.
11	VKM nr.429, datë 15.07.2021	“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme të hartimit të planit të rilevimit për zonat e stimuluar”.
12	VKM nr.409, datë 15.06.2022	“Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen”.
13	VKM nr.5, datë 11.01.2023	“Për përcaktimin e vlerës së tarifave dhe pagesave, masës së penaliteteve, si dhe të mënyrës së llogaritjes, mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave të arkëtuara nga proceset kalimtare të pronësisë”.
14	VKM nr.28, datë 27.01.2023	“Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe

		rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”.
15	VKM nr.446, datë 26.07.2023	“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kalimin e së drejtës së pronësisë dhe regjistrimin e pasurisë së legalizuar, pagesën, çmimin favorizues, kategoritë e subjekteve që përfitojnë falje, si dhe zbritjet e përqindjet e përdorimit të bonove të privatizimit”.
16	VKM nr.638, date 16.10.2024	“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme të bashkërendimit të punës ndërmjet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Agjencisë së Trajtimit të Pronave”.
17	VKM nr.329, datë 22.05.2019	“Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”.
18	VKM nr.782, datë 07.10.2020, ndryshuar me VKM nr.319, datë 29.05.2024	“Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.
19	VKM nr.781, datë 07.10.2020	“Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të regjistrimit të titujve të pronësisë që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”.
20	VKM nr.605, datë 29.07.2020	“Për regjistrimin e pemëve dhe të pasurive natyrore”.
21	VKM nr.389, datë 13.05.2020, ndryshuar me VKM nr.1177, datë 24.12.2020	“Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”.
22	VKM nr.1179, datë 24.12.2020, ndryshuar me VKM nr. 465, datë 17.07.2024.	“Për rregullat e përdorimit, administrimit dhe ruajtjes së bazës së të dhënave për pasuritë e paluajtshme dhe për miratimin e listës së institucioneve që kanë të drejtën e aksesit në sistemin elektronik të të dhënave”.
23	VKM nr.864, datë 27.12.2022	“Për miratimin e rregullave për procedurën e trajtimit të kërkesave për shërbime kadastrale”.
24	VKM nr.865, datë 27.12.2022	“Për kushtet, kriteret dhe procedurat e përfitimit, të poseduesve të ndërtimeve pa leje në rastet e fatkeqësisë natyrore”.
25	VKM nr.4, datë 11.01.2023	“Për rregullat e hollësishme, mënyrat dhe mjetet teknikohartografike për përmirësimin e regjistrit kadastral”.
26	VKM nr.639, datë 16.10.2024	“Për përcaktimin e elementeve të akteve noteriale, vendimeve gjyqësore apo akteve administrative, që kontrollohen për efekt regjistrimi”.

27	VKM nr.867, datë 10.12.2014, ndryshuar me VKM nr. 435, datë 26.6.2024	“Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”.
28	VKM nr.132, datë 07.03.2018, ndryshuar me VKM nr.457, datë 26.07.2023	“Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”.
29	Udhëzim nr.2307, datë 01.11.2023	“Për miratimin e modeleve të akteve për kalimin e pronësisë, të sipërfaqes shtetërore shtesë, si dhe të pronës shërbyese”.
30	Udhëzim nr.1, datë 17.07.2024	“Për miratimin e modelit dhe përcaktimin e rregullave të mbajtjes së regjistrit të lejes së ndërtimit, si dhe të procedurave të regjistrimit të kontratës së sipërmarrjes/porosisë dhe të premtimshitjes”.
31	Udhëzim nr.1557, datë 18.09.2024	“Rregullat e hollësishme për mënyrën e plotësimit dhe administrimit të akteve kadastrale”.
32	Udhëzim nr.1318, datë 18.07.2024	“Modeli dhe mënyra e plotësimit të dokumentacionit teknik”.
33	Udhëzim nr.788, datë 30.04.2024	“Për miratimin e modeleve të akteve në zbatim të pikës 32 të VKM-së nr. 1189, datë 24.12.2020”.
34	Udhëzim nr. 1320, datë 18.07.2024	“Për miratimin e dokumentacionit hartografik që hartohet për objektet pa titull pronësie, truallit të tyre funksional dhe të oborreve në përdorim”.
35	Urdhër Nr. 1456, datë 06.09.2024	“Për përditësimin dhe saktësimin e listës së dokumentacionit tekniko ligjore të kërkesave për shërbime kadastrale që ofrohen nga Drejtoritë/Zyrat Vendore të ASHK-së në zbatim të ligjit Nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

SHTOJCA 2. Model i formularit për llogaritjen e vlerës financiare të projektit

Referuar specifikimeve të përcaktuara në Kreun 9. “Oferta Financiare për projektin”, për llogaritjen e vlerës financiare të procesit mund të përdoret tabela me përmbajtje si më poshtë:

1. (Draft Model) Tabelë për vlerën financiare të RF për çdo lot

#	Emërtimi i lotit	Përshkrimi i shërbimit	Numri total i ZK-ve	Njësia	Nr. i pritshëm i Pasurive	Çmimi për njësi pa TVSH (në lek)	Vlera totale lek (pa TVSH)
1		(RF) Pasurit të paluajtshme të pritshme, për trajtim gjatë procesit, sipas parashikimeve		Pasuri			
2							

SHTOJCA 3. Model për ndarjen në lote të projektit

Në referim të specifikimeve të Kreut 8 “Specifikime për ndarjen në lote”, është paraqitur propozimi i modelit të ndarjes në lote të projektit, sipas ndarjes territoriale të Bashkive. Referuar këtij grupimi është sugjeruar ndarja e projektit në 7 lote, duke vlerësuar se kjo mënyrë i përgjigjet kushteve dhe kriterëve për ndarjen në lote, të argumentuara në Kreun 8 të këtyre specifikimeve.

Në vijim është paraqitur një tabelë e përgjithshme e ndarjes së loteve të sugjeruara, si dhe lista e detajuar e ZK-ve për secilin lot. Referuar informacionit të marrë nga DVASHK-të përkatëse, është paraqitur një numër paraprak i pasurive të pritshme për çdo ZK, për të parashikuar shpërndarjen e volumit të punës për çdo lot të sugjeruar.

Tabela 1:

Model i ndarjes në lote sipas Bashkive dhe i paraqitjes së ofertës financiare për Ofertuesit.

#	Përshkrimi i shërbimit	Loti	Bashkia	DVASHK	Numri total i ZK-ve	Njësia	Nr. Total i Pasurive të pritshme	Vlera në lek (pa TVSH)
1	Regjistrim Fillestar	Loti 1	1.Malësi e madhe	1. Malësi e madhe	9	Pasuri	7380	
2	Regjistrim Fillestar	Loti 2	1. Shkodër	2. Shkodër	20	Pasuri	11385	
3	Regjistrim Fillestar	Loti 3	1. Mirditë 2. Vau I Dejës 3. Fushë Arrës	1. Lezhë 2. Shkodër	11	Pasuri	4635	
4	Regjistrim Fillestar	Loti 4	1. Tropojë	1. Kukës	21	Pasuri	10080	
5	Regjistrim Fillestar	Loti 5	1. Has	1. Kukës	21	Pasuri	14805	
6	Regjistrim Fillestar	Loti 6	1. Bulqizë 2. Dibër 3. Kukës	1. Dibër 2. Kukës	18	Pasuri	10390	
7	Regjistrim Fillestar	Loti 7	1. Elbasan 2. Krujë	1. Elbasan 2. Durrës-Kavajë-Krujë	6	Pasuri	7110	
TOTALI					106	Pasuri	65785	


Tabela 2.
Ndarja e detajuar në lote sipas Bashkive

NR. I LOTIT	NR.	ZK	EMER	DVASHK / ZVASHK	BASHKIA	NR. I PRITSHËM PASURIVE (I PËRAFËRT)
Loti 1	1	1345	BZHETE	SHKODËR / ZV M.MADHE	MALËSI E MADHE	900
	2	1346	BZHETE-MAKAJ	SHKODËR / ZV M.MADHE	MALËSI E MADHE	180
	3	2199	KOKPAPAJ	SHKODËR / ZV M.MADHE	MALËSI E MADHE	540
	4	2258	KOZHJE	SHKODËR / ZV M.MADHE	MALËSI E MADHE	360
	5	2487	LOHE E POSHTME	SHKODËR / ZV M.MADHE	MALËSI E MADHE	2250
	6	2668	MESHQERRE	SHKODËR / ZV M.MADHE	MALËSI E MADHE	720
	7	3170	REPISHT	SHKODËR / ZV M.MADHE	MALËSI E MADHE	450
	8	3697	VAJUSH	SHKODËR / ZV M.MADHE	MALËSI E MADHE	1440
	9	3837	VUÇ-KURTAJ	SHKODËR / ZV M.MADHE	MALËSI E MADHE	540
Loti 2	1	1000	ABAT	SHKODËR	SHKODËR	225
	2	1264	BRASHTE	SHKODËR	SHKODËR	225
	3	1289	BRUÇAJ	SHKODËR	SHKODËR	540
	4	1448	DARRAGJAT	SHKODËR	SHKODËR	630
	5	1714	GIMAJ	SHKODËR	SHKODËR	720
	6	1769	GJURAJ-BOKS	SHKODËR	SHKODËR	450
	7	2400	LEKAJ	SHKODËR	SHKODËR	1800
	8	2492	LOTAJ	SHKODËR	SHKODËR	360
	9	2564	MALI GJYMTIT	SHKODËR	SHKODËR	225
	10	2775	NDREJAJ	SHKODËR	SHKODËR	540
	11	2777	NENMAVRIQ	SHKODËR	SHKODËR	450
	12	2791	NICAJ-SHALE	SHKODËR	SHKODËR	900
	13	2792	NICAJ-SHOSHE	SHKODËR	SHKODËR	270
	14	2859	PALAJ	SHKODËR	SHKODËR	360
	15	2894	PECAJ	SHKODËR	SHKODËR	270
	16	2904	PENTAR	SHKODËR	SHKODËR	1350
	17	2907	PEPSUMAJ	SHKODËR	SHKODËR	270
	18	2979	PLAN	SHKODËR	SHKODËR	810
	19	3842	VUKSANAJ	SHKODËR	SHKODËR	540
	20	3853	XHAN	SHKODËR	SHKODËR	450
Lot 3	1	1304	BUKMIRE	LEZHË	MIRDITË	720
	2	2534	LURTH	LEZHË	MIRDITË	540
	3	2551	MALAGJIKAJVALL	SHKODËR	VAU I DEJËS	360
	4	2773	NDERSHEN	LEZHË	MIRDITË	270
	5	2860	PALAJ-GUSHTE	SHKODËR	VAU I DEJËS	450
	6	3307	SERME	SHKODËR	VAU I DEJËS	180
	7	3571	TELUME-KLLOGJEN	SHKODËR	VAU I DEJËS	270
	8	3607	T'OPLAN	SHKODËR	VAU I DEJËS	540
	9	3672	UKBIBAJ	SHKODËR	VAU I DEJËS	540
	10	3772	VILE	SHKODËR	VAU I DEJËS	360
	11	3988	OROSH	SHKODËR	FUSHË ARRËS	405

NR. I LOTIT	NR.	ZK	EMER	DVASHK / ZVASHK	BASHKIA	NR. I PRITSHËM PASURIVE (I PËRAFËRT)
Lot 4	1	1223	BLLADE	KUKËS	TROPOJË	450
	2	1259	BRADOSHNIÇE	KUKËS	TROPOJË	450
	3	1283	BRISË	KUKËS	TROPOJË	315
	4	1432	CURRAJ I POSHTEM	KUKËS	TROPOJË	360
	5	1456	DEGE	KUKËS	TROPOJË	360
	6	1761	GJONPEPAJ	KUKËS	TROPOJË	540
	7	1862	GRI E RE	KUKËS	TROPOJË	180
	8	1993	JAHO SALIHI	KUKËS	TROPOJË	990
	9	2146	KERRNAJ	KUKËS	TROPOJË	630
	10	2251	KOVAÇE	KUKËS	TROPOJË	225
	11	2403	LEKBIBAJ	KUKËS	TROPOJË	630
	12	2407	LEKURTAJ	KUKËS	TROPOJË	720
	13	2602	MARKAJ	KUKËS	TROPOJË	450
	14	2761	MYHEJAN	KUKËS	TROPOJË	900
	15	2865	PALÇE	KUKËS	TROPOJË	315
	16	2875	PAPAJ	KUKËS	TROPOJË	270
	17	2911	PERAJ	KUKËS	TROPOJË	450
	18	3253	SALCE	KUKËS	TROPOJË	540
	19	3288	SELIMAJ	KUKËS	TROPOJË	495
	20	3588	TETAJ	KUKËS	TROPOJË	360
	21	3986	RAGAM-LLUGAJ	KUKËS	TROPOJË	450
Lot 5	1	1278	BRENOGE	KUKËS	HAS	270
	2	1349	CAHAN	KUKËS	HAS	360
	3	1599	FAJZE	KUKËS	HAS	450
	4	1683	GAJREP	KUKËS	HAS	540
	5	1788	GOLAJ	KUKËS	HAS	1350
	6	2152	KISHAJ	KUKËS	HAS	360
	7	2431	LETAJ	KUKËS	HAS	630
	8	2463	LIQENI I KUQ	KUKËS	HAS	495
	9	2674	METALIAJ	KUKËS	HAS	1170
	10	2731	MUJAJ	KUKËS	HAS	540
	11	2797	NIKOLIQ	KUKËS	HAS	990
	12	2910	PERAJ	KUKËS	HAS	810
	13	2950	PEROLLAJ	KUKËS	HAS	720
	14	2983	PLANI PATES	KUKËS	HAS	450
	15	3012	POGAJ	KUKËS	HAS	315
	16	3085	QARR	KUKËS	HAS	810
	17	3634	TREGTAN	KUKËS	HAS	720
	18	3794	VLAHEN	KUKËS	HAS	900
	19	3821	VRANISHT	KUKËS	HAS	1350
	20	3873	ZAHRIŠT	KUKËS	HAS	1080
	21	3911	ZGJEÇ	KUKËS	HAS	495

Nr,	NR. I LOTIT	ZK	EMER	DVASHK / ZVASHK	BASHKIA	NR. I PASURIVE (I PËRAFËRT)
Lot 6	1	1011	ALIAJ	KUKËS	KUKËS	360
	2	1111	BARDHAJ REÇ	DIBËR	DIBËR	405
	3	1338	BUZEMADHE	KUKËS	KUKËS	630
	4	1350	ÇAJE	KUKËS	KUKËS	720
	5	1662	FUSHE E VOGEL	DIBËR	DIBËR	495
	6	1743	GJINOVEC	DIBËR / ZV BULQIZË	BULQIZË	720
	7	1889	GURE REÇ	DIBËR	DIBËR	405
	8	1973	HURDHE REÇ	DIBËR	DIBËR	225
	9	2290	KRYEMADH	KUKËS	KUKËS	315
	10	2501	LUBALESH	DIBËR / ZV BULQIZË	BULQIZË	585
	11	2774	NDERSHENE	DIBËR	DIBËR	225
	12	3004	POCEST	DIBËR	DIBËR	1170
	13	3080	QAFE MURRE	DIBËR	DIBËR	495
	14	3406	SHPAT	KUKËS	KUKËS	360
	15	3482	SOHODOLL	DIBËR	DIBËR	1200
	16	3483	SOHODOLL I VOGEL	DIBËR	DIBËR	1000
	17	3851	XHAFERAJ	KUKËS	KUKËS	450
	18	4002	ÇERENEC I EPERM	DIBËR / ZV BULQIZË	BULQIZË	630
Lot 7	1	1118	BARKANESH	DURRËS-KAVAJË-KRUJË	KRUJË	630
	2	1474	DERSTIL	ELBASAN	ELBASAN	720
	3	1785	GODOLESH	ELBASAN	ELBASAN	1800
	4	1899	GURI I ZI	ELBASAN	ELBASAN	810
	5	2355	LABINOT-FUSHE	ELBASAN	ELBASAN	1890
	6	2432	LETANI	ELBASAN	ELBASAN	1260

Paraqitja në Hartë e loteve të sugjeruara, të ndara në ZK sipas Bashkive



Paraqitja në Hartë e loteve të sugjeruara, të ndara në ZK sipas Bashkive (ortofoto)

